



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 23**

**Datë 4 mars 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8/2014 datë 6.2.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës, gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse.....	539
Ligj nr. 9/2014 datë 13.2.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për programin “Fuqizimi i Agjencisë Shqiptare të Pagesave (AZHBR) për lëvrimin e kontributeve në bujqësi” .....	542
Ligj nr. 10/2014 datë 13.2.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Projekti pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi sigurimesh të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi” .....	556

**LIGJ**  
**Nr. 8/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR STATUSIN E  
ANËTARËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TË  
FORCËS SË SIGURISË SË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, GJATË QËNDRIMIT TË TYRE TË  
PËRKOHSHËM NË TERRITORIN E SHTETEVE  
PËRKATËSE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës, gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.2.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8501, datë 24.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR STATUSIN E  
ANËTARËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TË FORCËS SË  
SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS GJATË  
QËNDRIMIT TË TYRE TË PËRKOHSHËM NË  
TERRITORIN E SHTETEVE RESPEKTIVE**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, duke e konsideruar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë si shumë të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë,

me dëshirën për të vendosur rregulla për qëndrimet e përkohshme të anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës në territorin e shteteve respektive,

bien dakord si më poshtë:

**Neni 1**  
**Përkufizime**

1. “Forcë” nënkupton personelin që u përket Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

2. “Përbërës civil” nënkupton personelin civil që shoqëron një forcë.

3. “Person në varësi” nënkupton bashkëshortin/en e një anëtari të një force apo të një përbërësi civil, ose fëmijën/ët e një anëtari të tillë që është në varësi të tij apo të saj.

4. “Shtet pritës” nënkupton palën në territorin e së cilës është vendosur ose kalon transit forca ose përbërësi civil i shtetit dërgues.

5. “Shtet dërgues” nënkupton palën së cilës i përket forca që dërgohet në territorin e shtetit pritës.

**Neni 2**

**Qëllimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje rregullon procedurat e hyrjes, të daljes, të qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shtetit përkatës, si edhe të përbërësve civilë apo personave në varësi.

**Neni 3**

**Procedura dhe qëndrimi i përkohshëm**

Procedurat për hyrjen, daljen dhe qëndrimin e përkohshëm të anëtarëve të forcës, të përbërësve civilë dhe të personave në varësi, rregullohen me legjislacionin kombëtar të shtetit pritës. Qëndrimi i përkohshëm në territorin e shtetit pritës, sipas kësaj marrëveshjeje, ka për qëllim stërvitjen, trajnimin, kalimin transit, kryerjen e operacioneve të ndihmës humanitare, operacionet e kërkim-shpëtimit, si dhe aspekte të tjera të bashkëpunimit midis forcave. Detajet lidhur me qëllimin e qëndrimit, numrin e anëtarëve të forcës, përbërësve civilë dhe personave në varësi, vendin e dislokimit, kohëzgjatjen dhe informacione të tjera të nevojshme përcaktohen ndërmjet autoriteteve kompetente. Nëse do të gjykohet e nevojshme, mes palëve mund të lidhen marrëveshjet teknike përkatëse.

**Neni 4**

**Hyrja dhe dalja nga territori**

1. Anëtarët e forcës së shtetit dërgues duhet të jenë të pajisur me këto dokumente, kur hyjnë ose dalin nga kufiri i shtetit pritës:

1.1 Pasaporta ose Karta Ushtarake e Identitetit;

1.2 Urdhri për lëvizje, kolektiv ose individual, i lëshuar në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhën angleze apo frënge, nga institucioni përkatës i shtetit dërgues.

2. Përbërësi civil dhe personat në varësi duhet të jenë të pajisur me pasaporta ose karta identiteti.

3. Shteti pritës do t'i pranojë këto dokumente si dokumente të rregullta për hyrjen në pikat e kalimit kufitar nga anëtarët e forcës së shtetit dërgues, pa ndonjë kërkesë shtesë, me përjashtim kur specifikohet në marrëveshjet teknike pasuese.

4. Personeli i forcës së shtetit dërgues, kur kalon kufirin për të hyrë/dalë nga territori i shtetit pritës, duhet të jetë i veshur me uniformë ushtarake dhe t'i nënshtrohet detyrimit për zbatimin e rregullave të kontrollit kufitar.

#### Neni 5 Armatimi

1. Autoritetet kompetente të shtetit dërgues informojnë autoritetet kompetente të shtetit pritës për numrin, tipin dhe sigurojnë çdo informacion tjetër të nevojshëm mbi armët luftarake dhe municionet që anëtarët e forcës së shtetit dërgues do të kenë me vete gjatë qëndrimit të përkohshëm në shtetin pritës.

2. Personeli i forcës së shtetit dërgues mund të mbajë armë në zbatim të urdhrave të lëshuar nga autoritetet përkatëse së shtetit dërgues, bazuar në legjislacionin e shtetit pritës dhe në legjislacionin ndërkombëtar për këto raste. Autoritetet e shtetit dërgues do t'i shqyrtojnë me përparësi kërkesat nga shteti pritës për sa i përket çështjes së armatimit dhe municioneve.

#### Neni 6 Siguria publike dhe rendi kushtetues

Në rast se shteti pritës gjykon se siguria publike dhe rendi kushtetues i tij kërcënohet nga ana e një anëtari të forcës së shtetit dërgues, shteti pritës mund të kërkojë largimin e menjëhershëm të anëtarit/personit në fjalë nga territori i tij. Autoritetet e shtetit dërgues pajtohen me këtë kërkesë.

#### Neni 7 Respektimi i ligjeve dhe i zakoneve

Anëtarët e forcës së shtetit dërgues, përbërësit civilë dhe personat në varësi, angazhohen të respektojnë ligjet, rregullat, zakonet dhe traditat e shtetit pritës dhe të mos përfshihen në asnjë veprimtari që del jashtë misionit të tyre në territorin e shtetit pritës.

#### Neni 8 Juridiksioni

1. Autoritetet e shtetit dërgues kanë të drejtë të ushtrojnë brenda territorit të shtetit pritës juridiksion disiplinor, civil dhe penal mbi anëtarët e forcës së shtetit dërgues.

2. Autoritetet e shtetit pritës gëzojnë të drejtën për të ushtruar juridiksion ekskluziv mbi anëtarët e forcës së shtetit dërgues, mbi përbërësit civilë dhe personat në

varësi, në rastet e shkeljeve që janë të dënueshme nga legjislacioni i shtetit pritës dhe jo nga legjislacioni i shtetit dërgues, si edhe në rastet kur një nga subjektet e mësipërme kryen: shkelje që kanë të bëjnë me sigurinë, pavarësinë, rendin kushtetues dhe integritetin e shtetit pritës.

3. Autoritetet e shtetit pritës gëzojnë të drejtën parësore për të ushtruar juridiksion mbi anëtarët e forcës së shtetit dërgues për veprën penale të vrasjes, plagosjes së rëndë, vepra të tjera penale kundër integritetit fizik dhe seksual, me përjashtim të rastit kur këto veprime janë drejtuar kundër një anëtari të forcës së shtetit dërgues.

4. Autoritetet përkatëse të shtetit pritës dhe të shtetit dërgues do të bashkëpunojnë për zgjidhjen e të gjitha rasteve në të cilat ka të drejta që konkurrojnë me njëra-tjetrën për ushtrim të juridiksionit. Në qoftë se shteti që ka të drejtën parësore vendos të mos ushtrojë juridiksion, ai duhet të njoftojë menjëherë autoritetet e shtetit tjetër. Autoritetet e shtetit që kanë të drejtën parësore të ushtrimit të juridiksionit, do t'i përgjigjen me mirëkuptim kërkesës nga autoritetet e shtetit tjetër për një përjashtim nga e drejta e tij në rastet kur shteti tjetër mendon që një përjashtim i tillë është i një rëndësie të veçantë.

5. Nëse shteti pritës heq dorë nga e drejta për të ushtruar juridiksion penal ndaj një anëtari të forcës së shtetit dërgues, përbërësi civil apo personi në varësi, shteti dërgues e largon menjëherë të dyshuarin nga territori i shtetit pritës.

6. Autoritetet e shtetit pritës dhe të shtetit dërgues do të ndihmojnë dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për ndalimin dhe arrestimin e anëtarëve të forcave, përbërësit civilë ose personave në varësi të tyre dhe dorëzimin e tyre tek autoritetet kompetente.

7. Autoritetet e shtetit pritës dhe të shtetit dërgues do të ndihmojnë dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme dhe në mbledhjen dhe përpunimin e provave.

#### Neni 9 Kontrolli doganor

1. Anëtarët e forcës së shtetit dërgues, përbërësit civilë, si dhe personat në varësi të tyre u nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të vendosura nga autoritetet e doganave të shtetit pritës. Autoritetet doganore të shtetit pritës kanë të drejtën, sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga ligjet dhe rregullat e shtetit pritës, të kontrollojnë anëtarët e forcës së shtetit dërgues, përbërësit civilë dhe personat në varësi të tyre, të kontrollojnë bagazhet dhe automjetet e tyre, si edhe të sekuestrojnë artikujt që ndalohen me ligj të futen në territorin e shtetit pritës.

2. Dokumentet zyrtare, të pajisura me vulat zyrtare përkatëse, nuk do t'i nënshtrohen kontrollit doganor.

#### Neni 10

##### **Përfshirja nga taksat dhe detyrimet doganore**

1. Forca e shtetit dërgues mund të importojë pa doganë pajisje për forcën dhe sasi të arsyeshme ushqimesh, furnizimesh dhe mallra të tjera për përdorim ekskluziv të forcës. Në rastet kur lejohet nga shteti pritës, ky përfshirje përdoret edhe për përbërësit civilë të forcës dhe personat në varësi.

2. Forca e shtetit dërgues importon dhe rieksporron pa pagesë doganore automjetet e shërbimit, të nevojshme për përmbushjen e misionit të tij në territorin e shtetit pritës. Automjetet e shërbimit të forcës së shtetit dërgues përfshihen nga çfarëdo takse kombëtare të shtetit pritës lidhur me përdorimin e tyre.

3. Anëtarët e forcës, përbërësit civilë dhe personat në varësi të tyre mund të importojnë pa pagesë sendet dhe mobiliet personale, si edhe automjetet për përdorim personal. Automjetet për përdorim personal nuk përfshihen nga taksat kombëtare të shtetit pritës lidhur me përdorimin e tyre.

4. Atëherë kur nuk është i mundur përfshirja e plotë nga taksat, detyrimet doganore, tarifatat apo detyrime të tjera financiare, të përcaktuara në legjislacionin e shtetit pritës, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për personelin e forcës së shtetit pritës.

#### Neni 11

##### **Mbrojtja e mjedisit**

Shteti dërgues njih dhe pranon rëndësinë e mbrojtjes mjedisore në kontekstin e veprimtarive të realizuara nga anëtarët e forcave të tij të armatosura në shtetin pritës. Anëtarët e forcave të armatosura të shtetit dërgues pajtohen me dispozitat ligjore të shtetit pritës për mbrojtjen e mjedisit. Autoritetet kompetente të dy shteteve bashkëpunojnë ngushtë së bashku për të gjitha çështjet e mbrojtjes mjedisore, veçanërisht për përgatitjen e stërvitjeve.

#### Neni 12

##### **Leja e drejtimit të automjetit**

Autoritetet përkatëse të shtetit pritës do të njohin në mënyrë të ndërsjellë, për qëllim qarkullimi në territoret e tyre, lejet e drejtimit/patentat e rregullta kombëtare të shoferëve, të lëshuara nga autoritetet kompetente përkatëse të shtetit dërgues, brenda afatit të tyre të vlefshmërisë, sipas kuadrit të tyre të brendshëm ligjor, për një anëtar të forcës ose përbërës civil, dhe personat në varësi.

#### Neni 13

##### **Shëndeti publik**

1. Shteti dërgues respekton legjislacionin shëndetësor të shtetit pritës. Anëtarëve të forcës së shtetit dërgues mund t'u kërkohet të paraqesin një certifikatë zyrtare shëndetësore të lëshuar nga autoritetet e shtetit dërgues, e cila konfirmon se këta persona nuk vuajnë nga sëmundje ngjitëse.

2. Autoritetet kompetente të forcës së shtetit pritës njoftojnë autoritetet kompetente të forcës së shtetit dërgues mbi këtë kërkesë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së planifikuar të hyrjes.

3. Në rastin kur konstatohet se një anëtar i forcës së shtetit dërgues është i infektuar me një sëmundje ngjitëse dhe përbën rrezik për komunitetin, autoritetet përkatëse të shtetit pritës kërkojnë izolimin e përkohshëm ose largimin e menjëhershëm të personit nga territori i shtetit pritës.

#### Neni 14

##### **Pretendimet mbi dëmet e shkaktuara**

1. Pretendimet për dëmshpërblim, në rast dëmsh, të shkaktuara pasurisë së shtetit pritës nga anëtarët e forcës së shtetit dërgues, gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, trajtohen sipas legjislacionit civil të shtetit pritës. Autoritetet kompetente të palëve angazhohen të bashkëpunojnë ngushtë, duke ndihmuar njëra-tjetrën për zgjidhjen e çështjes.

2. Pretendimet për dëmshpërblim nga palët e treta, në rast dëmsh, të shkaktuara pasurisë së tyre nga anëtarët e forcës së shtetit dërgues trajtohen nga autoritetet kompetente të shtetit pritës, të cilat kanë detyrën të informojnë menjëherë autoritetet kompetente të shtetit dërgues. Këto të fundit analizojnë rastin dhe dërgojnë pranë autoriteteve të shtetit pritës raportin e tyre.

3. Autoritetet kompetente të shtetit pritës vendosin nëse duhet paguar dëmshpërblimi dhe në çfarë shume është i justifikuar pretendimi i palës së dëmtuar, sipas ligjit të shtetit pritës. Dëmshpërblimi i paguhet palës së tretë të dëmtuar, duke zbatuar raportin: 75% e shumës së dëmshpërblimit nga shteti dërgues dhe 25% nga shteti pritës.

4. Autoriteti i shtetit pritës paguan shumën e kompensimit në monedhën e tij vendase. Ai i kërkon autoritetit të shtetit dërgues të rimbursojë shumën e paguar. Autoriteti i shtetit dërgues rimbursos shumën përkatëse brenda tre muajve.

#### Neni 15

##### **Heqja dorë nga pretendimet**

Palët tërheqin të gjitha pretendimet e tyre për plagosjen ose vdekjen e çdo anëtari të forcës, të ndodhur gjatë kryerjes së detyrave të tij zyrtare, me përfshirje të rasteve kur pasoja ka ardhur për shkak të veprimeve me dashje ose nga pakujdesia.

Neni 16  
**Shërbimet mjekësore**

Shteti pritës ka për detyrë të sigurojë për personelin e forcës së shtetit dërgues asistencë mjekësore dhe dentare në të njëjtat kushte, si të personelit të forcës së tij.

Neni 17  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim, me anë të konsultimeve dypalëshe dhe nuk do t'i referohet një pale të tretë për zgjidhje.

Neni 18  
**Zbatimi**

1. Masat që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje realizohen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të cilat vënë në dijeni njëra-tjetrën mbi pikat e duhura të kontaktit për zbatimin e saj.

2. Palët mund të nënshkruajnë në të ardhmen, nëse e gjykojnë të nevojshme, marrëveshje teknike në përputhje dhe në zbatim të kësaj marrëveshjeje.

Neni 19  
**Plotësimi dhe ndryshimi**

Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të të dyja palëve.

Neni 20  
**Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të dyja palët kanë njoftuar njëra-tjetrën mbi përmbushjen e kërkesave ligjore shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Data e hyrjes në fuqi mbetet data e marrjes së njoftimit të fundit.

Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të papërcaktuar kohe. Marrëveshjes mund t'i jepet fund nga secila palë me anë të një njoftimi me shkrim për këtë qëllim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi i marrëveshjes hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit.

E bërë në Prizren, më 1 korrik 2013, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëloj autentike. Në rast të paqartësive në interpretim apo në zbatim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
MINISTRI I MBROJTJES  
**Arben Imami**

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
MINISTËR I FSK-së  
**Agim Çeku**

**LIGJ**  
**Nr. 9/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR PROGRAMIN  
“FUQIZIMI I AGJENCISË SHQIPTARE TË  
PAGESAVE (AZHBR) PËR LËVRIMIN E  
KONTRIBUTEVE NË BUJQËSI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për programin “Fuqizimi i Agjencisë Shqiptare të Pagesave (AZHBR) për lëvrimin e kontributeve në bujqësi”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.2.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8502, datë 24.2.2014 të  
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR REALIZIMIN E  
PROGRAMIT “FUQIZIMI I AGJENCISË SË  
PAGESAVE SHQIPTARE (AZHBR) PËR LIVRIMIN  
E KONTRIBUTEVE NË BUJQËSI”**

*Duke pasur parasysh se:*

- në datën 2 dhjetor 2008 është firmosur në Tiranë Marrëveshja kuadër e bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë (Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim) dhe qeveria e Shqipërisë (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), të dyja në vijim të quajtura “Palët”, kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje (këtu e në vijim e quajtur “Marrëveshja”);

Protokolli dypalësh i Bashkëpunimit për Zhvillim 2010 - 2012, i firmosur në Tiranë më 12 prill 2010, parashikon një financim kredie ndihme për shumën 10 milionë euro për një "Program të modernizimit të sektorit të bujqësisë", që përfshin tri nisma: i) krijimin e një skeme sigurimi në favor të ndërmarrjeve të vogla e të mesme bujqësore (SME-të); ii) mbështetjen për krijimin e Agjencisë së Pagesave - AZHBR"; dhe iii) fuqizimin e ullishtarisë;

- në datën 3.6.2011, me shkresën me nr. prot. 2533, Pala shqiptare ka përcjellë propozimin për projekt të quajtur "Fuqizimi i Agjencisë së Pagesave Shqiptare (AZHBR) për livrimin e kontributeve në bujqësi", duke i kërkuar me këtë rast Palës italiane një financim në shumën 5.000.000,00 euro;

- pas fazës përgatitore të projektit të kryer nga zyrat përgjegjëse të DPBZH-së, Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (MPJ-DPBZH) italiane, në takimin e datës 8 qershor 2012, ka miratuar dhënien e një kredie ndihme prej 5.000.000,00 eurosh, për realizimin e nismës "Fuqizimi i Agjencisë së Pagesave Shqiptare (AZHBR) për livrimin e kontributeve në bujqësi", në vijim e quajtur "Programi".

Sa më sipër u parashtrua, Palët kontraktuese bien dakord për sa vijon:

#### Neni 1

##### **Përmbajtja dhe përkufizimet në Marrëveshje**

1.1 Marrëveshja përbëhet nga 16 nene dhe nga bashkëlidhjet e mëposhtme:

"Bashkëlidhja 1" - Përmbledhje e Programit;

"Bashkëlidhja 2" - Kriteria të zgjedhshmërisë, klauzola etike dhe parime të përgjithshme të kontratave;

"Bashkëlidhja 3" - Plani financiar;

"Bashkëlidhja 4" - Mënyra e ekzekutimit dhe e administrimit të kredisë së ndihmës.

1.2 Bashkëlidhjet e sipërpërmendura janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e Marrëveshjes.

1.3 Fjalët dhe akronimet e përmendura në tekstin në vijim kanë kuptimin e mëposhtëm:

"Ambasada e Italisë" - Ambasada e Italisë në Tiranë.

"AT" - asistencë teknike e dhënë në kuadrin e Programit.

"AZHBR" - Agjencia e Pagesave e Zhvillimit Bujqësor e Rural.

"Marrëveshje financiare" - marrëveshje mes Ministrisë së Financave shqiptare dhe menaxhuesit të fondit qarkullues.

"Donator" - qeveria italiane.

"MFQ" - Menaxhues i Fondit Qarkullues: Instituti financiar italian, që menaxhon për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë fondet e kredisë

së ndihmës të parashikuara në Marrëveshje, apo ndryshe Artigiancassa.

"MBUMK" - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e Shqipërisë.

"MEF" - Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Italisë.

"MFSH" - Ministria e Financave e Shqipërisë.

"NJMP" - Njësia e Menaxhimit të Projektit.

"KD" - Komiteti i Drejtimit.

"NJTL" - Njësia Teknike Lokale - Zyra e Kooperacionit për Zhvillim e Ambasadës së Italisë në Tiranë.

#### Neni 2

##### **Qëllimi i Marrëveshjes**

2.1 Kjo Marrëveshje synon të rregullojë zbatimin, administrimin dhe përgjegjësitë e Palëve për realizimin e Programit.

2.2 Për këtë qëllim, Marrëveshja sanksionon angazhimin e të dyja Palëve për respektimin e Programit, me vëmendje të veçantë ndaj afateve dhe kushteve për përdorimin e kredisë përkatëse.

#### Neni 3

##### **Përshkrimi i Programit**

3.1 Programi, përmbledhja e shkurtër e të cilit tregohet në bashkëlidhjen 1, ka këta objektiva të përgjithshëm:

i) të ndihmojë në procesin e integritit evropian të Republikës së Shqipërisë, përmes përfundimit të *acquis communautaire* në fushën e bujqësisë;

ii) të ndihmojë në përmirësimin e të ardhurave të ndërmarrjeve bujqësore.

3.2 Objektivi specifik i Programit kërkon të pajisë Agjencinë e Pagesave Shqiptare (AZHBR) të Sistemit të Integruar të Menaxhimit dhe Kontrollit - SIMK (*Integrated Administration and Control System - IACS*), kërkuar nga Bashkimi Evropian, si instrument i detyrueshëm për administrimin e rregullt të kontributeve dhe lehtësimeve në bujqësi të parashikuara nga kuadri rregullues komunitar.

#### Neni 4

##### **Angazhime të qeverisë italiane**

Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, angazhohet të financojë Programin me një shumë prej 5.000.000,00 eurosh, si kredi ndihme, e cila do të jetë e disponueshme pranë Artigiancassa-s dhe do të livrohet sipas sa tregohet qartë në bashkëlidhjet 3 dhe 4.

## Neni 5

### Angazhime të qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare angazhohet:

5.1 Të garantojë realizimin e Programit në përputhje me Marrëveshjen. Për këtë qëllim do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarive dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe angazhimet fillestare të përcaktuara në “kuadrin logjik” të Programit, siç tregohet në bashkëlidhjen 1;

5.2 T’i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për realizimin me sukses të Programit;

5.3 Të krijojë pranë MBUMK-së, që do të bëhet enti zbatues, NJMP-në, e cila do të kujdeset të bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe menaxhues, të nevojshme për realizimin e Programit;

5.4 Të japë bashkëpunim të plotë për MPJ-DPBZH-në për veprimtarinë e monitorimit të Programit dhe për aksesin në dokumentacionin ekzistues;

5.5 Të rimburojë shumat e marra si kredi ndihme, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 8.

## Neni 6

### Struktura të menaxhimit dhe realizimit të Programit

Struktura menaxhuese dhe mënyrat e realizimit të Programit, siç tregohet në hollësi në bashkëlidhjet 1 dhe 4, parashikojnë:

6.1 MBUMK-ja, që do të realizojë Programin, do të përgatisë të gjitha marrëveshjet e nevojshme me institucionet përgjegjëse, do të firmosë kontratat e kërkuara dhe do të jetë përgjegjëse për përdorimin e fondeve dhe për kredinë e ndihmës sipas mënyrave dhe procedurave të përcaktuara nga Marrëveshja Financiare;

6.2 MFSH-ja, që do të lidhë Marrëveshjen Financiare;

6.3 Komiteti i Drejtimit (KD), që do të vigjilojë mbi efikasitetin dhe eficiencën e Programit dhe do të kryejë të gjitha funksionet sipas sa përcaktohet në bashkëlidhjen 1. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shqiptare: MBUMK-së dhe AZHBR-së, nga një përfaqësues i MPJ-DPBZH-së dhe, në cilësinë e vëzhguesit, nga një përfaqësues i entit realizues;

6.4 Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP), që do të jetë operative për gjithë kohëzgjatjen e Programit dhe do të ngarkohet me zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe me bashkërendimin e të gjitha organeve të sipërtreguara, duke garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Marrëveshje;

6.5 MPJ-DPBZH, që do të sigurojë livrimin e burimeve financiare si kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni italian në fuqi, siç tregohet në përmblendhjet në këtë Marrëveshje. MPJ-DPBZH, në bashkëpunim me MBUMK-në, do të ketë,

gjithashtu, për detyrë të mbikëqyrë ecurinë e Programit. MPJ-DPBZH-ja do të veprojë përmes zyrave përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veta. Në veçanti, NJTL-ja do të sigurojë të gjitha funksionet me karakter teknik në mbështetje të Programit;

6.6 Artigiancassa, që sipas udhëzimeve të MPJ-DPBZH-së dhe të MEF-it, do të lidhë me MFSH-në një Marrëveshje Financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve si kredi ndihme. Në kuadrin e kësaj marrëveshjeje financiare, Artigiancassa do të sigurojë livrimin e transheve të kërkuara nga MBUMK për zbatimin e Programit dhe do të kujdeset për lidhjen e çdo kontrate për ofrimin e shërbimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. Ajo do të kujdeset, gjithashtu, për pagesën e shumave të kontratës në favor të organizmave realizues;

6.7 Ambasada/NJTL në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e nevojshme me karakter teknik dhe do të garantojë ecurinë e rregullt të veprimtarive. Në kuadrin e funksioneve të veta institucionale, Ambasada/NJTL do të sigurojë, gjithashtu, kontaktet e nevojshme me palët partnere të Programit, duke u kujdesur, ndër të tjera, për marrjen dhe përcjelljen e gjithë dokumentacionit zyrtar.

## Neni 7

### Mënyrat e përdorimit të kredisë së ndihmës dhe procedurat e përcaktimit të përfituesit

Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ-DPBZH-së, ashtu siç tregohet në hollësi në bashkëlidhjen 4, hapat kryesorë që duhen ndjekur për përdorimin e fondit si kredi ndihme, janë si vijon:

7.1 Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje të Projektit;

7.2 Nxjerrja nga ana e MEF-it, me propozim të MPJ-së, e një dekreti ministror, që autorizon Artigiancassa-n të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshjen financiare me MFSH-në;

7.3 Lidhja e marrëveshjes financiare mes Artigiancassa-s dhe MFSH-së;

7.4 Përgatitje e dokumentacionit të tenderit dhe/ose prokurimit të drejtpërdrejtë për ofrimin e shërbimeve të asistencës teknike, shërbime dhe punime të inxhinierisë informatike dhe për furnizimin e të mirave nga ana e NJMP-së;

7.6 Verifikim kompetence, nga ana e MPJ-DPBZH-së, i dokumenteve të përgatitura të tenderit;

7.7 Në rast rezultati pozitiv, kryerjen e tenderave të mësipërm dhe shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit, të krijuar nga ministria kompetente shqiptare dhe shpalljen e fituesit;

7.8 Verifikim i përputhshmërisë nga ana e MPJ-DPBZH-së e procedurës së ndjekur për përzgjedhjen dhe i kontratave që duhen lidhur dhe, në rast rezultati pozitiv, lidhja e kontratave përkatëse nga ana e MBUMK-së;

7.9 Mbështetje e kontratave të veçanta të lidhura dora-dorës në marrëveshjen financiare.

Prokurimi i shërbimeve, i punimeve dhe i furnizimeve për realizimin e programit, do të kryhet përmes kryerjes së tenderave të rregulluar nga dispozitat që përmban manuali i procedurave (PRAG) i përfutur nga Komisioni Evropian - versioni i fundit së bashku me shtojcat përkatëse, përshtatur me ligjin nr. 49/87, ashtu siç tregohet në bashkëlidhjen 2.

Do të mund të kryhen shpenzime në vend deri në një maksimum prej 35% të shumës së kredisë.

#### Neni 8

##### **Afate dhe kushte të kredisë së ndihmës**

Afatet dhe kushtet financiare të kredisë së ndihmës janë si vijon:

- kohëzgjatja: 26 vjet, nga të cilat 16 vjet pa pagesë principali;

- përqindja e interesit: 0,0 %.

Në bazë të kushteve aktuale financiare, kredia e ndihmës parashikon një përqindje interesi për dhënien e barabartë me 60%.

#### Neni 9

##### **Mënyra të livrimit të kredisë së ndihmës**

Kredia e ndihmës do të livrohet sipas dy mënyrave të ndryshme, në bazë të tipologjisë së shpenzimeve, siç saktësohet në bashkëlidhjen 3.

A. - Për shpenzime të bëra drejtpërsëdrejt nga enti zbatues, mënyra do të jetë si vijon:

9.1 Transhi i parë, i barabartë me 50% të shumës së treguar në bashkëlidhjen 3 (ref. A), do të livrohet me kërkesë të MFSH-së për MFQ-në, pasi të përmbushen parakushtet e mëposhtme:

- nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e marrëveshjes financiare ndërmjet MFSH-së dhe MFQ-së;
- krijimi i organeve të administrimit të Programit;
- përzgjedhja e shoqërisë së auditimit.

9.2 MFSH-ja do të paraqesë kërkesë për transhin e dytë, baras me 30% të shumës së treguar në bashkëlidhjen 3, kur të jetë angazhuar 80% e shumës së transhit të parë dhe të jetë livruar konkretisht 40% e tij. MBUMK-ja do t'i bashkëlidhë kërkesës një raport të detajuar të saj dhe të certifikuar nga shoqëria e auditit, i cili do të evidentojë vlefshmërinë e çdo veprimi. Livrimi i transhit do të bëhet pas verifikimit me sukses të këtij raporti nga ana e MFQ-së, me përjashtim të sa vendosur në pikën 9.5. MFQ-ja do të kujdeset të njoftojë MPJ-DPBZH-në në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

9.3 Kur MBUMK-ja do të ketë angazhuar shumën për një vlerë më të madhe se 80% e totalit të livruar me transhin e parë dhe të dytë dhe të ketë livruar konkretisht 40% të tyre, MFQ-ja do të bëjë kërkesë për transhin e tretë (20%), duke paraqitur një raport të

detajuar dhe të certifikuar nga shoqëria e auditimit. Livrimi i transhit varet nga rezultati pozitiv i verifikimit të këtij raporti nga ana e MFQ-së, përveç sa vendoset në pikën 9.5. MFQ-ja do të kujdeset të njoftojë MPJ-DPBZH-në në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

9.4 Në përfundim të të gjitha veprimeve, MBUMK-ja do të paraqesë një raport përfundimtar, të certifikuar nga shoqëria e auditimit. Ky raport do të duhet të miratohet nga MPJ-DPBZH-ja dhe nga MFQ-ja, përveç sa vendosur në pikën 9.5.

9.5 Qeveria shqiptare angazhohet në mënyrë të pakthyeshme t'i rimburojë MFQ-së fondet që do të konsiderohen si të papërdorura kurrë, në rastin kur kontrolli i kryer nga shoqëria e auditimit mbi dokumentacionin kontraktor do të kishte rezultat negativ.

B. - Për shpenzime të kryera me fitim tenderi dhe/ose prokurim të drejtpërdrejtë për furnizim shërbimesh, punimesh dhe mallrash (bashkëlidhja 3, ref. B), livrimi do të bëhet sipas mënyrës së përshkruar në bashkëlidhjen 4, seksioni IV.

#### Neni 10

##### **Veprimtari të monitorimit dhe të kontrollit**

Palët angazhohen të kryejnë gjithë sa është e nevojshme për arritjen e objektivave të Programit dhe për të monitoruar e për të kontrolluar vazhdimisht përdorimin e fondeve dhe çdo kusht tjetër të përmendur në Marrëveshje. Në veçanti, arritja konkrete e objektivave do të vlerësohet kohë pas kohe në përputhje me skemën e treguesve që përmban "kuadri logjik" i Programit, gjatë mbledhjeve të takimit të Komitetit të Drejtimit.

Vlerësime të mundshme gjatë rrugës dhe përfundimtare do të bëhen nën kujdesin e DPBZH-së. Ato do të bëhen në marrëveshje me njësinë e MBUMK-së, e cila do të ngarkohet me monitorimin e projekteve që përfitojnë financime ndërkombëtare.

#### Neni 11

##### **Klauzola kundër korrupsionit**

Qeveria e Republikës së Italisë është angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij. Në veçanti, me qëllim që të shmanget çdo mundësi për veprimtari të paligjshme dhe parregullsi gjatë paraqitjes së ofertave për furnizime, shërbime dhe punime civile, qeveria italiane ka parashikuar detyrimin për gjithë pjesëmarrësit në tendera që të nënshkruajnë dhe paraqesin shtojcën *Integrity Pact* (Pakti i Integritetit), së bashku me ofertat e tyre ose me kontratat e miratuara. Mosparaqitja e dokumentacionit të mësipërm do të sjellë automatikisht përjashtimin nga tenderi ose do të përbëjë arsye për të zbatuar sanksionet përkatëse të *Integrity Pact*, në rast mosrespektimi të



angazhimeve kundër korrupsionit gjatë zbatimit të kontratës. Vendosija e kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë të rregullt dhe shanse të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe një zbatim të rregullt dhe transparent të kontratës së miratuar.

Neni 12  
**Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshje që mund të lindin gjatë zbatimit të Programit duhet të zgjidhen me mirëkuptim përmes konsultimeve mes MBUMK-së dhe MPJ-DPBZH-së nëpërmjet Ambasadës së Italisë.

Neni 13  
**Pengesa dhe forca madhore**

Në rast pengese për realizimin e Programit, për shkak forcash madhore (luftë, përmytje, zjarr, stuhi, tërmet, konflikte pune, greva, akte të qeverive përkatëse, vështirësi të paparashikuara në transporte dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët, ose në rast rreziku ose kushtet e rrezikshme për personelin e transferuar jashtë atdheut, do të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

13.1 Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më e vogël se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara ndërpritet deri kur MPJ-DPBZH-ja do të autorizojë rifillimin e veprimtarive;

13.2 Nëse kohëzgjatja e pengesës do të ishte më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të merren vesh për vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë veprimet e mëtejshme. Në rast pamundësie për të vazhduar veprimtarinë, Palët duhet të vendosin mbi përdorimin e fondeve të paangazhuara. Në mungesë të një marrëveshjeje, Pala shqiptare angazhohet të rimbursojë shumat e mbetura.

Neni 14  
**Denoncimi i Marrëveshjes**

Palët ruajnë të drejtën të denoncojnë këtë Marrëveshje nëse do të vërtetohej një prej rasteve të mëposhtme:

14.1 Mosrealizim i objektivave të parashikuar në Program për shkaqe që nuk kanë të bëjnë me Palën italiane;

14.2 Gabim i rëndë nga ana e MBUMK-së, si vonesa të pajustificuara dhe të zgjatura në kohë (më të mëdha se nëntë muaj), të tilla që do të vinin në rrezik arritjen e objektivit të Programit, përdorim i fondeve për arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen financiare, vonesë e zgjatur në paraqitjen e raporteve të parashikuara;

14.3 Pengesë ose forcë madhore e zgjatur në kohë, sipas sa përcaktohet në klauzolat e nenit të mësipërm 13;

14.4 Në rast gabimi të rëndë, si në pikën 14.2, MPJ-DPBZH-ja duhet të njoftojë me shkrim për sa ka ndodhur MBUMK-në, duke e ftuar të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda një periudhe maksimale prej 90 ditësh nga data e njoftimit. Pas mbarimit të këtij afati, MPJ-DPBZH-ja ruan të drejtën të zgjidhë Marrëveshjen;

14.5 Në të dyja rastet e tjera të sipërpërmendura, MPJ-DPBZH-ja mund të vendosë në mënyrë të njëanshme denoncimin e Marrëveshjes, duke e njoftuar MBUMK-në me një notë verbale, të paktën 3 muaj më parë. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MBUMK-ja është e detyruar të ndërpresë veprimtaritë e Programit, përveçse kur është rënë dakord ndryshe mes Palëve.

Në rast denoncimi të Marrëveshjes, qeveria shqiptare duhet t'i kthejë MPJ-DPBZH-së të gjitha fondet e livruara që nuk janë shpenzuar ende në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas njoftimit të tij të njëra prej Palëve kontraktuese.

Neni 15  
**Ndryshimi**

Palët mund të propozojnë ndryshime në Marrëveshje përmes shkëmbimit të notave verbale. Ndryshimet për të cilat Palët mund të bien dakord do të hyjnë në fuqi sipas procedurave përkatëse të brendshme të parashikuara sipas rastit.

Neni 16  
**Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Çdo palë duhet ta njoftojë me shkrim Palën tjetër në lidhje me përfundimin e procedurave kombëtare të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të fundit.

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje do të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e kredisë.

Në besim të sa më sipër, të nënshkruarit përfaqësues, rregullisht të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

U nënshkrua në Tiranë, më 12.12.2012, në dy kopje origjinale, një në gjuhën italiane dhe një në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhesh në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën italiane do të mbizotërojë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:  
**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

**Genc Ruli**

Për qeverinë e Republikës së Italisë:  
**AMBASADORI I ITALISË NË TIRANË**

**Massimo Gaiani**

**BASHKËLIDHJA 1**  
**PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PROGRAMIT**  
**“FUQIZIMI I AGJENCISË SË PAGESAVE**  
**SHQIPTARE - AZHBR - PËR LIVRIMIN E**  
**KONTRIBUTEVE NË BUJQËSI”**

Ky Program i kredisë së ndihmës, për një vlerë prej 5 milionë eurosh, është pjesë e Protokollit dypalësh të Bashkëpunimit për Zhvillim 2010 - 2012, i firmosur më 12 prill 2010, nga ministri Frattini dhe nga zëvendëskryeministri shqiptar i atëhershëm Ilir Meta. Autoritetet shqiptare e shohin me përparësi absolute këtë nismë në mbështetje të Agjencisë së Pagesave, pasi ky institucion i nënshtrohet një procesi rigoroz akreditimi pranë DG AGRI, si agjenci kombëtare për livrimet e fondeve të bujqësi.

**OBJEKTIVA TË PROGRAMIT**

Programi “Fuqizimi i Agjencisë së Pagesave Shqiptare - AZHBR - për livrimin e kontributeve në bujqësi” synon të ndihmojë në mbështetjen e Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit evropian dhe, në veçanti, në adaptimin e *acquis communautaire* në fushën e bujqësisë, duke përmirësuar administrimin e kontributeve për ndërmarrjet bujqësore dhe të ardhurat e tyre. Ky objektivi rezulton të jetë strategjik për qeverinë shqiptare, sepse do të mundësojë aksesin ndaj fondeve komunitare të parashikuara në kuadrin e politikës së përbashkët për bujqësinë (PPB/CAP), me ndikime vërtet të mira për popullsinë shqiptare që merret me sektorin e bujqësisë.

Më konkretisht, ndërhyrja synon të pajisë AZHBR-në (Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor e Rural) me një sistem të integruar të menaxhimit dhe të kontrollit (*Integrated Administrative and Control System - IACS*) dhe me të gjithë ata komponentë që shoqërojnë dhe plotësojnë këtë sistem, ashtu siç kërkohet nga Bashkimi Evropian, si instrument i detyrueshëm për menaxhimin e rregullt të kontributeve dhe lehtësimeve, të parashikuara nga kuadri rregullues komunitar.

Veçanërisht, komponentët kryesorë për t'u realizuar janë:

- harmonizim i kuadrit rregullues;
- përshtatje e organizimit të AZHBR-së;
- krijim i infrastrukturës teknologjike;
- krijim i infrastrukturës aplikative;
- krijim i LPIS-së (Sistemi i Identifikimit të Parcelës Bujqësore/*Parcel Identification System*);
- krijim i Regjistrit të Fermës (*Farm Register*);
- zbatim i masave për zhvillimin rural.

**REZULTATET E PRITSHME**

Me qëllim që të arrihet objektivi specifik, si më lart treguar, brenda periudhës së kohëzgjatjes së Programit është parashikuar arritja e rezultateve të mëposhtme, përveçse e një administrimi dhe bashkërendimi të sigurt:

1. Legjislacioni vendas parësor dhe dytësor i përshtatshëm (a) dhe kuadër organizativ dhe procedural i plotësuar dhe i përshtatur (b). Kjo përbëhet nga këto veprime:

1.1 Harmonizimi i legjislacionit ekzistues me kuadrin ligjor të BE-së përmes përcaktimit të legjislacionit vendas shqiptar, parësor dhe dytësor, në bazë të transpozimit komunitar të elementeve të sistemit të integruar të menaxhimit dhe të kontrollit (IACS) të përcaktuar nga neni 15 i rregullores së KE-së nr. 73/2009);

1.2 Plotësim dhe përshtatje e strukturës organizative të AZHBR-së, përmes realizimit të një drejtorie të re të veçantë për autorizimin e ndihmave të drejtpërdrejta (AND), në gjendje të menaxhojë në radhë të parë ndihmat e drejtpërdrejta kombëtare dhe, në të ardhmen, ndihmat e drejtpërdrejta komunitare, ashtu siç parashikohen në kuadrin e sistemit të integruar të menaxhimit dhe të kontrollit (IACS);

1.3 Realizim i procedurave administrative dhe operative të nevojshme për funksionimin e aparatit administrativ të AZHBR-së.

2. Qendra e të dhënave e plotësuar dhe infrastrukturë aplikative e realizuar. Kjo do të bëjë të mundur dhënie e kapaciteteve të nevojshme përpunuese dhe do të sigurojë administrimin e saktë të informacioneve grafike dhe alfanumerike që ndodhen në sistem, që do të pajiset me komponentët *software*, parashikuar nga Projekti, të domosdoshëm për të siguruar funksionimin e rregullt të Agjencisë dhe për mbështetjen e fermerëve në plotësimin e kërkesave për ndihmë.

3. Sistemi i përcaktimit dhe i klasifikimit të parcelave bujqësore (LPIS) i realizuar në bazë të Rreg. (KE) 1593/2000. Kjo rregullore ka ndërfutur një sistem identifikimi territorial të bazuar në sisteme LPIS (*Land Parcel Identification System*), që e tejkalon nivelin informativ alfanumerik dhe sjell përdorimin e teknikave të informatizuara në kuadrin e sistemeve GIS për identifikimin e ngastrave të deklaruara nga fermerët përmes përdorimit të imazheve të ortoretifikuara.

4. Regjistri i fermës, i plotësuar përmes krijimit të një regjistri të përgjithshëm kombëtar të ndërmarrjeve bujqësore shqiptare, ku katalogohen të gjitha informacionet në lidhje me pronësinë, shtrirjen territoriale, prodhimin, mjetet mekanike etj., të çdo ndërmarrjeje bujqësore.

5. a) Dhënie e mbështetjes së duhur për zbatimin e masave të zhvillimit rural përmes përcaktimit dhe hartimit të procedurave për zbatimin e masave të Programit të Zhvillimit Rural (PZHR), në bazë të reformës së ardhshme të politikës së përbashkët bujqësore.

b) Trajnim dhe komunikim i realizuar. Detyra e tyre do të jetë të ofrojnë një shërbim tejet të rëndësishëm për

sa i takon përfuturim nga ana e funksionarëve të administratës së potencialiteteve dhe të funksionaliteteve të sistemit të ndihmave në bujqësi. Këto do të jenë tipologjitë e veprimtarive trajnuese që do të realizohen:

- trajnim teorik me mënyrë realizimi “në vend” apo ndryshe me lektor në sallë dhe pjesëmarrës në klasa;

- *e-learning* me një sistem trajnimi në distancë të bazuar në përdorimin e teknologjive të rrjetit për të projektuar, zgjedhur, menaxhuar dhe zgjeruar të nxënësve të administratës;

- trajnimi në punë (*training on the job*) që qëndron kryesisht në shoqërimin e personelit të administratës me figura profesionale të furnitorit (*Tutor*), që gëzojnë aftësitë e nevojshme teknike dhe kapacitetet e duhura mësimore;

- fushatë komunikimi me objektivin për të promovuar marrëdhënien që ekziston mes prodhimit bujqësor dhe mundësive që ofron politika komunitare.

#### VEPRIMTARI QË SYNOJNË ARRITJEN E REZULTATEVE

Për arritjen e rezultateve, si më sipër treguar, përveç krijimit të njësisë së menaxhimit, parashikohet të realizohen veprimtaritë e mëposhtme:

1. Mbështetje për përshtatjen e kuadrit ligjor, organizativ dhe procedural:

##### 1.1 Kuadri ligjor

- Analizë e legjislacionit shqiptar;  
- Analizë e legjislacionit komunitar;  
- *Gap analysis* e legjislacionit;  
- Mbështetje për përgatitjen e legjislacionit parësor dhe dytësor ekzistues;

- Mbështetje për vlerësimin e BE-së në lidhje me përputhjen e legjislacionit vendas me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian.

##### 1.2 Organizimi i AZHBR-së

- Përcaktim i numrit të burimeve njerëzore të nevojshme;

- Përcaktimi i aftësive profesionale dhe i kapaciteteve të nevojshme;

- Përzgjedhje e profesionistëve të përshtatshëm për të mbuluar detyrat administrative që mungojnë.

##### 1.3 Procedura administrative dhe operative

- Përgatitje e procedurave administrative (manuale) që u përgjigjen kriterëve komunitare.

2. a) infrastruktura teknologjike (specifika në bashkëlidhjen I)

- Analizë e kriterëve;  
- Projektim dhe implementim i programeve (*software-ve*) bazë;

- Projektim dhe implementim i rrjetit të transmetimit të të dhënave.

2. b) Infrastrukturë aplikative (specifika në bashkëlidhjen II)

- Analizë e kriterëve (funksionale, teknologjike, të shërbimeve);

- Projektim dhe implementim i programeve (*software-ve*).

3. Krijim i LPIS-së (specifika në bashkëlidhjen III)

- Analizë e shtresave informative ekzistuese;

- Krijim i blloqeve fizike dhe foto interpretimi;

- Krijim dhe etiketim me kod të personalizuar;

- Foto interpretimi dhe analizë e mbulimit të tokës për përcaktimin e sipërfaqeve të zgjidhshme.

4. Krijim i regjistrit të fermës (specifika në bashkëlidhjen III)

- Në marrëveshje me administratën shqiptare, përcaktimi i një kodi të personalizuar për ekonominë bujqësore, si në rastin kur është person fizik ashtu dhe kur bëhet fjalë për një kooperativë;

- Fuqizim i *data base-ve* ekzistues;

- Thirrje e fermerëve;

- Fuqizim i *data base-it*.

5. a) Mbështetje për zbatimin e masave për zhvillimin rural (specifika në bashkëlidhjen IV)

- Përcaktim i manualeve të procedurave për kontrollet me karakter teknik dhe administrativ;

- Hartim i manualeve, i orientimeve dhe i dokumenteve të tjera për zbatimin e Programit të Zhvillimit Rural;

- Identifikim i kuadrit referues të kontrolleve dhe përcaktim;

- Përshtatje e procedurave informatike për menaxhimin e masave për zhvillimin rural;

- 2 vizita studimore në Itali.

5. b) Trajnim dhe komunikim

- Veprimtari trajnimi në klasë;

- *E-learning*;

- Trajnim në punë (*training on the job*);

- 2 fushata komunikimi.

Programi parashikon një sërë masash të nevojshme për të siguruar administrimin e rregullt të tij:

i) Do të krijohet brenda MBUMK-së një NJMP, e cila do të gëzojë mbështetjen teknike dhe financiare të vetë Programit;

ii) Do të krijohet një Komitet Drejtimi (KD), organ orientues dhe kontrolli, që do të duhet të sigurojë udhëheqjen strategjike të Programit;

iii) Do të vihen në dispozicion nga ana e MPJ/DPBZH-së, burime për kontrolle dhe/ose vlerësime të Programit nëse do të shiheshin të nevojshme;

iv) Do të sigurohen, nga ana e MBUMK-së, burimet e nevojshme për mbulimin e disa kostove lokale (taksa, detyrime doganore etj.).

Komiteti i Drejtimit, që do të mblidhet çdo gjashtë muaj, sa herë që do të shihet e nevojshme me kërkesë të njërit prej anëtarëve të vet, do të ketë detyrat e mëposhtme:

- Drejton dhe mbikëqyr ecurinë e Programit;

- Miraton dhe vleftëson procedurat e administrimit të Programit;

- Miraton, gjatë mbledhjes së parë, kushtet referuese në lidhje me institucionin publik italian që duhet përzgjedhur dhe ekspertët italianë që ky i fundit do të vërë në dispozicion;

- Vendors politikat e përgjithshme dhe orienton drejt zgjedhjeve strategjike;

- Ndihmon shkëmbimin e përvojave dhe kontakteve ndërmjet aktorëve dhe zbatuesve;

- Lehtëson integrimin me projekte dhe veprimtari të tjera që nxisin sinergji pozitive dhe konstruktive, duke shmangur ndërhyrje të kryera nga nisma të tjera;

- Miraton planet operative, raportet teknike dhe financiare të përgatitur nga NJMP-ja.

Gjatë mbledhjes së Komitetit, NJMP-ja do të kryejë detyrën e sekretariatit teknik.

## BASHKËLIDHJA 2

### KRITERE TË ZGJEDHSHMËRISË, KLAUZOLA ETIKE, PARIME TË PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

Kjo bashkëlidhje harmonizon botimin e fundit të “Norma dhe procedura në lidhje me përfitim të mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punimeve për kontrata të financuara me bilancin e përgjithshëm të Komisionit Evropian në kuadrin e programeve të bashkëpunimit me vendet e treta” me parimet themelore të legjislacionit italian në lidhje me veprimtaritë e “prokurimit” dhe ndihmës për zhvillim. Ajo do të përfshihet, gjithashtu, në kuadrin e parimeve themelore të legjislacionit të vendit përfitues në fushën e prokurimeve.

#### 1. ZGJEDHSHMËRIA E KONTRAKTUESIT

##### 1.1 Rregulla objektiviteti dhe asnjëansie

Për të shmangur çfarëdolloj konflikti interesi, çdo person fizik ose juridik (përfshirë këtu subjekte që u përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë konsorciumesh, bashkime të përkohshme shoqërisht dhe nënkontraktuesish), që mund të ketë marrë pjesë në përgatitjen e Projektit duhet përjashtuar nga tenderi ose nga paraqitja e ofertave për realizimin e tij.

1.2 Rregulla për kapacitetin ekonomik, financiar, profesional dhe teknik

Kandidatët/konkurrentët duhet të provojnë që kapacitetet e tyre ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike janë të përshtatshme për realizimin e veprimtarive të parashikuara në kontratë. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në Marrëveshje, kandidatët/konkurrentët duhet të provojnë:

1.2.1 Kapacitet ekonomik dhe financiar. Totali i faturuar nga kandidatët/konkurrentët në tri vitet e mëparshme, për të njëjtën kategori objekt të prokurimit, duhet të jetë të paktën i barasvlershëm me shumën maksimale të kontratës; shoqëritë që kanë më pak se tre

vjet jetë mund të provojnë kapacitetin e vet ekonomik dhe financiar me çdo dokument që porositësi do ta shihte të përshtatshëm, i cili do të tregojë në rregulloren e tenderit;

1.2.2 Kapacitet teknik dhe profesional. Kandidatët/konkurrentët duhet të përgatisin një raport të plotë të veprimtarive të realizuara gjatë tri viteve të mëparshme; shoqëritë e krijuara që kanë më pak se tre vjet jetë mund të provojnë kapacitetin e tyre teknik dhe profesional me çfarëdolloj dokumenti që porositësi do ta shihte të përshtatshme, që do të përcaktohet në rregulloren e tenderit;

1.2.3 Për kontratat e punës, kandidatët/konkurrentët italianë duhet të fitojnë kualifikimin në përputhje me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 34/2000 (dhe ndryshime ose amendamentet e mëvonshme të tij). Kandidatët/konkurrentët joitalianë duhet të fitojnë kualifikimet në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare.

1.3 Shkaqe për përjashtim nga pjesëmarrja në tender Përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit, dhe as nuk mund të shpallen fitues apo të lidhin kontratat përkatëse, personat fizikë ose juridikë, që:

1.3.1 gjenden në një prej rrethanave të përmendura në dekretin legjislativ italian të datës 8.8.1994 nr. 490 (Antimafie). Kandidatët/konkurrentët italianë duhet të paraqesin “vërtetimin antimafie” të lëshuar nga autoritetet italiane kompetente. Kandidatët/konkurrentët joitalianë duhet të paraqesin dokumentacion të njëjtë, nëse parashikohet nga legjislacionet përkatëse kombëtare;

1.3.2 janë në gjendje falimentimi ose në likuidim të detyruar, ose gjenden në administrim gjyqësor, ose në procedurë për shlyerje kreditorësh, ose kanë ndërprerë veprimtaritë e tyre, ose gjenden në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga kuadri ligjor ose nënligjor kombëtar;

1.3.3 u janë nënshtruar procedurave të shpalljes së falimentimit ose likuidimit të detyruar, administrimit të kontrolluar, ose procedurës për shlyerje të kreditorëve, ose ndodhen në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar;

1.3.4 ato ose drejtuesit e tyre, ose partnerët/ortakët, janë dënuar për një krim në lidhje me sjelljen profesionale, me një vendim të formës së prerë;

1.3.5 janë fajtorë për sjellje të keqe profesionale të provuar me çfarëdolloj mjete që porositësi është në gjendje të përdorë;

1.3.6 nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore me pagesën e sigurimeve shoqërore të parashikuara nga legjislacioni i vendit ku kanë selinë ligjore dhe/ose u kërkohet të punojnë;

1.3.7 nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni i vendit ku kanë selinë ligjore dhe/ose ku u kërkohet të punojnë;

1.3.8 janë fajtorë për deklarata të rreme në dhënien e informacioneve të kërkuara nga MPJ/DPBZH-ja si kusht për pjesëmarrjen në një procedurë tenderi ose për shpalljen fitues të një kontrate;

1.3.9 kanë pësuar zgjidhje të një kontrate të mëparshme për mospërmbushje, në kuadrin e një kontrate tjetër me MPJ/DPBZH-në dhe/ose financim me fonde italiane.

## 2. PARIME TË PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

2.1 Prokurimi dhe realizimi i veprave dhe i punimeve publike, shërbimeve dhe furnizimeve, në bazë të këtij kodi, duhet të garantojë cilësinë e shërbimeve dhe të kryhet në respektim të parimeve të leverdisë ekonomike, efikasitetit, shpejtësisë dhe rregullsisë; prokurimi duhet, gjithashtu, të respektojë parimet e konkurrencës së lirë, të trajtimit të barabartë, të mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe çdo herë që të jetë e mundur, atë të të qenit publik.

2.2 Pas një marrëveshjeje paraprake mes palëve, parimi i leverdisë ekonomike mund t'u nënshtrohet nevojave sociale, si dhe mbrojtjes së shëndetit dhe të mjedisit, dhe të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

2.3 Procedura e prokurimit duhet të anulohet nëse ka më pak se tre kandidatë/ofertues të përshtatshëm.

2.4 Duhet të sigurohet e drejta e aksesit në dokumentacionin administrativ të përgatitur nga institucioni prokurues, me përjashtimet e mëposhtme:

- informacione të ofertuesve që përbëjnë sekrete teknike ose tregtare, dëshmi apo vërtetime për to me vetëdeklarim të arsyetuar ose të provuar;

- opinione ligjore të marra nga institucioni prokurues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ardhshme ose të tanishme;

- relacione konfidenciale të subjektit përgjegjës për kryerjen e punimeve ose të organit kolaudues për kërkesat ose rezervat e ekzekutuesit të kontratës.

2.5 Kontratat nuk mund të ndryshohen pa një miratim të qartë paraprak të MPJ/DPBZH-së, dhe në çdo rast mund të bëhen ndryshime vetëm në respektim të klauzolave të mëposhtme. Fituesit e kontratës nuk kanë të drejtë për pagesa ose rimbursime të asnjë lloji për veprimtari të realizuara pa autorizimin paraprak. Nëse MPJ/DPBZH-ja ose porositësi do ta kërkonin, fituesit të kontratës do t'i duhet që me shpenzime të vetat të rikthejë gjendjen në kushtet e mëparshme.

2.6 Ekzekutuesi i kontratës duhet të përbëjë një garanci dorëzanie për të siguruar dëmshpërblimin për dëme të mundshme që rrjedhin nga një zbatim i keq ose i pjesshëm i kontratës, ai duhet, gjithashtu, të lidhë një policë sigurimi për dëme që mund të shkaktohen gjatë zbatimit të kontratës.

2.7 Dokumentacioni i tenderit duhet të specifikojë bazën e ankandit për kontratën që do të shpallet fituese.

2.8 Variante të kontratave të furnizimit të mallrave dhe të shërbimeve janë të vlefshme vetëm pasi të jetë

dhënë autorizimi i MPJ/DPBZH-së, që mund të jepet vetëm në këto raste:

2.8.1 Për nevoja që rrjedhin nga dispozita ligjore dhe nënligjore që dalin pas lidhjes së kontratës;

2.8.2 Për rrethana të paparashikuara dhe të paparashikueshme, përfshirë këtu mundësinë e përdorimit të materialeve të reja, komponentëve dhe teknologjive që nuk ekzistojnë në kohën kur ka nisur procedura e tenderit, me kusht që ato të përmirësojnë cilësinë e produktit ose të shërbimit, pa rritur për këtë arsye shumën e përgjithshme të kontratës;

2.8.3 Kur ndodhin ngjarje që lidhen me natyrën ose cilësinë e mallrave ose të vendeve në të cilat ndërhyhet, gjatë zbatimit të kontratës dhe që nuk do të ishin të parashikueshme në kohën e lidhjes së kontratës;

2.8.4 Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, ndryshimet e sipërpërmendura nuk do të mund të rrisin ose të ulin më shumë se 20% shumën e përgjithshme të kontratës;

2.8.5 Pranohen, gjithashtu, ndryshime që, në interesin e vetëm të porositësit, do të sillnin një rritje ose një ulje të shërbimeve të fituesit të kontratës deri në një maksimum prej 5% të totalit të kontratës, me kusht që ato të kenë si qëllim përmirësimin ose funksionimin më të mirë të shërbimeve objekt i kontratës, të mos sillnin ndryshime thelbësore dhe burimet financiare shtesë të jenë të disponueshme; këto ndryshime mund të arsyetohen vetëm nga nevoja objektive, që rrjedhin nga rrethana që janë shfaqur ndërkohë dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së kontratës;

2.8.6 Fituesit e kontratës janë të detyruar t'u nënshtrohen varianteve si më sipër treguar në të njëjtat kushte të kontratës;

2.8.7 Në çdo rast fituesit e kontratës kanë për detyrë të zbatojnë të gjitha variantet me karakter thelbësor që do të konsiderohen të nevojshme nga porositësi, me kusht që ato të mos ndryshojnë në thelb natyrën e veprimtarive objekt i kontratës dhe të mos sjellin shpenzime më të mëdha.

2.9 Variantet e kontratave të punës janë të vlefshme vetëm pas një autorizimi paraprak të MPJ/DPBZH-së, që do të mund të jepet vetëm në rastet e mëposhtme:

2.9.1 Për nevoja që rrjedhin nga dispozita ligjore dhe nënligjore që nxirren pas lidhjes së kontratës;

2.9.2 Për shkaqe të paparashikuara dhe të paparashikueshme ose sepse ndërkohë është shfaqur mundësia e përdorimit të materialeve, të komponentëve dhe të teknologjive që nuk ekzistojnë në kohën e projektimit e që mund të sjellin, pa rritje kostoje, përmirësime të ndjeshme në cilësinë e veprës ose të pjesëve të saj dhe gjithnjë nëse nuk do të ndryshonin formulimin e projektit fillestar;

2.9.3 Për shkak të ekzistencës së ngjarjeve që kanë të bëjnë me natyrën dhe specifikat e mallrave në të cilat

ndërhyhet e që kanë ndodhur gjatë kryerjes së punimeve ose të rrethanave të paparashikuara ose të paparashikueshme në fazën e Projektit;

2.9.4 Probleme gjeologjike të paparashikueshme në projektzbatimin;

2.9.5 Për shkak të shfaqjes së gabimeve ose mosveprimeve në Projektin e zbatimit, të cilat do të vinin në rrezik, tërësisht ose pjesërisht, realizimin e veprës apo përdorimin e saj; në këtë rast, mbajtësit e detyrave të projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësuar nga institucionet prokuruese; fituesit e kontratës nuk do të mund të mos pranojnë këto ndryshime, me kusht që kostoja e tyre të mos kalojë 20% të vlerës së totalit të kontratës;

2.9.6 Ndryshime që, në interesin e porositësit, sjellin një rritje ose një ulje të shërbimit të ofruar nga fituesi i kontratës deri në një maksimum prej 5% të totalit të kontratës, dhe që do të ishin të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e veprave/punimeve, pranohen me kusht që burimet financiare shtesë të jenë të disponueshme;

2.10 Kontratat nuk mund t'u kalohen të tretëve, pasi kjo do të sillte zgjidhjen me të drejtë të kontratave të dhëna më parë.

2.11 Nënspërmarrja pranohet deri në një maksimum prej 30% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumentacioni i tenderit duhet të saktësojë nëse nënspërmarrja lejohet dhe, nëse po, të përcaktohen kushtet përkatëse. Konkurrentët duhet të deklarojnë, në ofertat e tyre, se cilët furnitorë/shërbime/punime mendojnë të punojnë me nënspërmarrje. Fituesit e kontratës duhet të depozitojnë kontratat përkatëse të nënspërmarrjes pranë institucionit prokurues të paktën 20 ditë përpara fillimit të punimeve objekt i nënspërmarrjes. Nënspërmarrësit duhet të jenë të zgjedhshëm për furnizimet/shërbimet/punimet që do të duhet të realizojnë, sidomos në lidhje me kushtet që përmbajnë paragrafët nga 1.3.1 në 1.3.7 të kësaj bashkëlidhjeje.

2.12 Çmimet e kontratës janë fikse dhe nuk mund të rishikohen.

2.13 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen vetëm në euro. Rrisqet dhe ndryshime të kursit të këmbimit nuk i nënshtrohen asnjë kompensimi.

2.14 Kontrata zgjidhet me të drejtë nëse fituesit e saj u nënshtrohen procedurave të falimentimit ose likuidimit të detyruar, administrimit gjyqësor ose procedurës së shlyerjes së kreditorëve, ose nëse ndodhen në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni përkatës kombëtar.

2.15 Në rast faji ose gabimi të rëndë, nuk pranohet kufizimi i përgjegjësisë së fituesve të kontratës.

2.16 Zbatimi i kontratës rregullohet nga ligji i vendit përfitues.

2.17 Institucioni prokurues duhet të emërojë një përgjegjës për zbatimin e kontratës, me detyra kontrolli dhe bashkëpunimi me fituesin e kontratës dhe të garancisë që të mbrohet interesi publik i ekzekutimit të objektit të kontratës me cilësinë më të mirë dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.18 Mosmarrëveshjet që do të lindnin mes fituesve të kontratës dhe institucionit prokurues nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

2.19 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e sipërpërmendura.

2.20 Në rastin e një boshllëku ligjor, Pala italiane ruan të drejtën të zbatojë parimet themelore të legjislacionit italian.

### 3. KOSTO TË PRANUESHME DHE TË PAPANUESHME

3.1 Kostot e nxjerra në kontrata janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për realizimin e Projektit sipas dokumentit të Projektit.

3.2 Në çdo rast, kostot përkatëse të këtyre mallrave/shërbimeve/punimeve nuk konsiderohen të pranueshme:

a) mallra jo të domosdoshme apo luksi (p.sh.: parfume, artikuj kozmetikë, vepra arti, pije alkoolike, artikuj sportivë etj.);

b) mallra, shërbime dhe punime civile që lidhen drejtpërsëdrejt ose tërthorazi me veprimtari ushtarake dhe të policisë;

c) të gjitha taksat dhe tatimet indirekte (përfshirë TVSH-në) dhe të drejtat doganore;

d) amortizime të borxheve të marra më parë dhe humbjeve të ardhshme të përfituesit ose përdoruesve të fundit;

e) interesa që u detyrohen të tretëve nga ana e përfituesit ose përdoruesve të fundit.

### 4. KLAUZOLA ETIKE

4.1 Çdo përpjekje e bërë nga ana e konkurrentëve (të mundshëm dhe jo), për të marrë informacione konfidenciale, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë, ose për të ndikuar institucionin prokurues në fazat e shqyrtimit, të krahasimit dhe të vlerësimit të ofertave, do të shpjerë në përjashtimin nga tenderi të konkurrentit/ëve, dhe në eliminimin, për rrjedhojë, të ofertës së tij/tyre, përveç aplikimit të sanksioneve administrative.

4.2 Pa autorizimin paraprak me shkrim të autoritetit prokurues, fituesit e kontratës dhe personeli i tyre, apo cilado shoqëri/sipërmarrje me të cilën do të bashkohen ose lidhen fituesi i kontratës nuk do të mund të realizojnë, as në formë plotësimi apo nënspërmarrjeje, punime apo të furnizojnë mallra në kuadrin e kësaj kontrate. Ky ndalim gjen zbatim për çdo projekt që për shkak të natyrës së kontratës do të shpinte në lindjen e një konflikti interesi për fituesin e kontratës.

4.3 Në paraqitjen e ofertës së vet në një tender, konkurrentët duhet të deklarojnë se nuk kanë asnjë konflikt të mundshëm interesi, dhe se nuk kanë asnjë lidhje specifike me konkurrentët e tjerë ose me palë të tjera që janë përfshirë për arsye të ndryshme në Projekt. Nëse një rrethanë e tillë do të shfaqej gjatë ekzekutimit të kontratës, fituesit e saj duhet të njoftojnë menjëherë institucionin prokurues.

4.4 Funksonarë shtetërorë apo personel tjetër në administratën publike të vendit përfitues, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin ndodhen, nuk mund të angazhohen si ekspertë/konsulentë të shoqërive/sipërmarrjeve që marrin pjesë në tender pa pasur më parë një autorizim të MPJ/DPBZH-së.

4.5 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të veprojnë gjithnjë me paanshmëri dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk mund të bëjnë deklarata publike në lidhje me Projektin ose shërbimet që u kërkohen atyre, pa pasur më parë pëlqimin e institucionit prokurues. Ata (në çdo rast) nuk mund të angazhohen në asnjë mënyrë institucionin prokurues pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të tij.

4.6 Për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e saj, personeli i tyre dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të angazhohen të mos cenojnë parimet, traditat dhe zakonet politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti, fituesit e kontratave duhet të respektojnë standardet themelore të punës, siç përcaktohen në konventat kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO (si “Konventa mbi lirinë e sindikatës dhe mbrojtja e së drejtës së sindikatës”, “Konventa për të drejtën e organizimit dhe negocimit kolektiv”, “Konventa për punën e detyruar”, “Konventa për diskriminimin (punësim dhe profesion)” dhe “Konventa për format më të këqija të punës së të miturve”).

4.7 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm nuk mund të pranojnë pagesa që lidhen me kontratën, të ndryshme nga ato të parashikuara në vetë atë. Fituesit e kontratës, personeli i tyre dhe nënkontraktuesit nuk duhet të ushtrojnë asnjë veprimtari ose të marrin asnjë përfitim nga ana e institucionit prokurues që nuk do të përputhet me detyrimet përkatëse kontraktuale.

4.8 Përbën detyrim për fituesit e kontratës, personelin e tyre dhe nënkontraktues të mundshëm, që të ruajnë sekretin profesional për gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të marra nga fituesi i kontratës janë konfidenciale.

4.9 Kontrata duhet të rregullojë përdorimin, nga ana e të gjithë kontraktuesve, e raporteve dhe e dokumenteve të hartuara, marrë ose paraqitur prej tyre gjatë zbatimit të kontratës.

4.10 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të shmangin çdo marrëdhënie/lidhje që do të vinte në rrezik/paragjykonte pavarësinë e tyre ose të personelit të tyre. Nëse fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit nuk do të ishin më të pavarur, autoriteti porosites, përveç dëmshpërblimit të mundshëm të dëmeve që mund të jenë shkaktuar, mund të zgjidhë kontratën pa njoftim paraprak, dhe pa qenë e nevojshme që fituesi i kontratës të ngrejë pretendime për dëmshpërblim.

4.11 MPJ/DPBZH-ja ruan të drejtën të ndërpresë dhe të anulojë financimin e Projektit, nëse praktika korrupsioni të çfarëdolloji do të shfaqeshin në çdo fazë të procedurës së shpalljes së fituesit, dhe nëse autoriteti porosites nuk do të ishte në gjendje të merrte të gjitha masat e duhura për zgjidhjen e rrethanës së shfaqur. Për efekte të kësaj klauzole, “praktika të korrupsionit” janë dhënie ryshfeti apo mitdhënia, dhurata, donacione ose komisione, të nënkuptuara si stimul ose shpërblim për çdo person që ka kryer ose nuk ka kryer qëllimisht çdo veprim në lidhje me prokurimin ose realizimin e një kontrate të lidhur me autoritetin porosites.

4.12 Më saktësisht, i gjithë dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përkatëse për punime, furnizime dhe shërbime, duhet të përmbajnë klauzolën që parashikon anulimin e tenderit ose zgjidhjen e kontratës nëse do të rezultonte se shpallja e fituesit ose ekzekutimi i kontratës do të kenë shkaktuar shpenzime tregtare jo të zakonata. “Shpenzime tregtare jo të zakonata” janë komisione a shpenzime të papërmendura në kontratën kryesore, ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur rregullisht dhe që i referohet kontratës kryesore, komisione të papaguara pas shërbimeve të ligjshme dhe realisht të ofruara, komisione të paguara në një parajsë fiskale, komisione të paguara te një përfitues që nuk është qartësisht i identifikuar, ose komisione të paguara për një shoqëri që duket se kërkon të mbulojë një shoqëri tjetër.

4.13 Fituesit e kontratës, nëse do t’u kërkohet nga MPJ/DPBZH-ja, angazhohen të japin elemente provuese për të shpjeguar kushtet në të cilat zbatohet kontrata. MPJ/DPBZH-ja mund të kryejë çdo kontroll, dokumentacioni ose në vend, që do ta shihte të arsyeshëm për të mbledhur elemente prove në rast shpenzimesh tregtare të pazakonta, të dyshimta.

4.14 Fituesit e kontratës që kanë paguar shpenzime tregtare të pazakonta në projekte të financuara nga MPJ/DPBZH-ja, në varësi të rëndësisë së fakteve të konstatuara, u nënshtrohen zgjidhjes së kontratës ose përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me financime të MPJ/DPBZH-së.

4.15 Mosrespektimi i një apo më shumë klauzolave etike nga ana e konkurrentit ose fituesit të kontratës dhe të nënsipërmarrësit, kur parashikohet nënsipërmarrja, mund të sjellë përjashtimin e tyre nga

kontrata të tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, nga MPJ/DPBZH-ja, dhe aplikimi i penaltiteve. Individit ose shoqëria që do të konsiderohet përgjegjës/e duhet të informohet me shkrim për këtë fakt.

4.16 Përbën detyrim për autoritetin prokurues që procedurat e përfundimit të mallrave dhe të shërbimeve të përcaktohen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe pavarësisht nga çdo ndikim i jashtëm.

**BASHKËLIDHJA 3  
PLANI FINANCIAR**

Nr.	Tender/tipologji	K.ndihme vlerësim euro	K. ndihme efektive	Mënyra e livrimit	Kontraktuesi	Shpenzime lokale %	
A	<b>Njësia e Menaxhimit të Projektit</b>	<b>551.400,00</b>		50% paradhënie pas një kërkesë nga MFSH-ja, 30% pas evidentimit të angazhimit për të paktën 80% të transhit të parë, livrim efektiv i 40% të tij dhe kontroll më pas i një shoqërie auditimi. Pjesa e mbetur pas evidentimit të angazhimit të 80% të dy transeve të para, livrimit efektiv të 40% të tyre dhe raport pozitiv i shoqërisë së pavarur të auditimit .	Institucioni zbatues është MBUMK-ja që do të krijojë një NJMP për menaxhimin dhe koordinimin e Programit.		
	0.1	ekspert italian	180.000,00				
	0.2	personel teknik	114.000,00				
	0.3	kosto administrimi dhe funksionimi	156.000,00				
	0.4	të ndryshme (auditim, përkthime, interpretim, dieta, shërbime etj.)	101.400,00				
B	<b>Përshatje e kuadrit ligjor, organizativ dhe procedural</b>	<b>88.770,00</b>		Me livrim nga ana e Artigiancassas për subjekte fituese pas caktimit të çdo kontrate dhe shqyrtimit të faturave.	Për t'u prokuruar me tender dhe/ose me prokurim të drejtpërdrejtë tek institucione publike italiane (asistencë teknike institucionale).	MAKS. 35,00	
1.1	Asistencë teknike e ligjore	88.770,00					
	<b>Projektim dhe zhvillim i infrastrukturave teknologjike dhe aplikative</b>	<b>1.500.400,00</b>					
2.1	Asistencë e specializuar për projektim infrastrukturash teknologjike dhe aplikative AZHBR, asistencë teknike dhe transferim i njohurive	708.400,00					
2.2	Zhvillim e MEV infrastruktura teknologjike dhe aplikative	792.000,00					
	<b>Krijimi i LPIS</b>	<b>437.736,00</b>					
3.1	Asistencë teknike e specializuar për ngritjen dhe transferim të njohurive të menaxhimit të LPIS-t	437.736,00					
	<b>Krijim i Regjistrit të Fermës</b>	<b>724.400,00</b>					
4.1	Asistencë teknike e specializuar për ngritje dhe transferim të njohurive të menaxhimit të Regjistrit të Fermës	724.400,00					
	<b>Mbështetje për zbatimin e masave për zhvillimin rural</b>	<b>589.160,00</b>					
5.1	Asistencë teknike e specializuar për përgatitjen e planeve të SR dhe						



		procedurave administrative dhe të kontrollit, vizita studimore	589.160,00			
		<b>Trajnim dhe asistencë menaxhimi dhe teknike për funksionarë të AZHBR-së</b>	<b>218.134,00</b>			
	6.1	Ofrim i planeve të trajnimit dhe transferim i njohurive për menaxhimin ICAS dhe masat e SR	218.134,00			
		<b>Furnizim mallrash</b>	<b>890.000,00</b>			
	7.1	Automjete				
	7.2	Pajisje dhe infrastrukturë teknike dhe teknologjike	890.000,00			
		<b>TOTALI i Programit</b>	<b>5.000.000,00</b>			

**BASHKËLIDHJA 4**  
**MËNYRA TË EKZEKUTIMIT DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS**  
**SEKSIONI 0**  
**VEPRIMTARI PËRGATITORE DHE LIVRIMI I**  
**FONDEVE NË ADMINISTRIM TË MBUMK-së**

1. MBUMK-ja do të kujdeset të emërojë anëtarët e NJMP-së (4 persona) dhe do të vijojë më pas me përzgjedhjen e një eksperti italian, me përvojë dhe aftësi të provuara në sektorin e ndërhyrjes dhe me njohje të thelluar të vendit, në bazë të termave të referencës, të përcaktuar bashkërisht (MBUMK/MPJ-DPBZH). Ky ekspert, i kontraktuar dhe i shpërblyer nga MBUMK-ja nga fondet e kredisë së ndihmës, do të kujdeset të japë asistencë teknike për NJMP-në në kryerjen e detyrave të veta, për gjithë kohëzgjatjen e Programit (30 muaj).

2. MBUMK-ja, me mbështetjen e NJMP-së, do të përcjellë kërkesën për kreditim të transhit të parë të fondeve sipas sa përcaktohet në nenin 8 të Marrëveshjes.

**SEKSIONI I**  
**NISJA E VEPRIMTARIVE DHE MIRATIMI I**  
**PLANIT TË PROKURIMIT**

1. NJMP-ja, e asistuar nga eksperti italian, siç tregohet në pikën 1, seksioni 0, përgatit propozimin për planin e prokurimit që do të përcillet nga MBUMK-ja në MPJ-DPBZH, përmes Ambasadës.

2. Plani i prokurimit duhet të organizohet në bazë tenderash, duke përcaktuar shumat e disponueshme (në nivel vlerësimi) dhe tipologjinë e tenderave që duhet ndjekur (në bazë të sa parashikuar në nenin 7 dhe në bashkëlidhjen 2. Kjo nëndarje duhet të mbajë parasysh mundësinë për të kryer shpenzime në vend deri në një maksimum prej 35% të vlerës së kredisë.

3. NJMP-ja do të kryejë tendera të hapur për subjekte italiane publike dhe private. Në rast veprimtarish specifike të asistencës teknike institucionale, MBUMK-ja mund të prokurorë detyrën përmes tenderave dhe/ose prokurimeve të drejtpërdrejta tek institucione publike italiane.

4. MPJ/DPBZH-ja do të shqyrtojë kështu planin e prokurimit nga pikëpamja teknike dhe ligjore dhe, në

rast rezultati pozitiv, do ta miratojë, duke dhënë njoftim zyrtar për MBUMK-në, nëpërmjet Ambasadës/NJTL.

**SEKSIONI II**  
**SHPLLJA E NJOFTIMIT PËR TENDER,**  
**PROCEDURA E ZBATIMIT**

NJMP-ja do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen e tenderave përkatës. Ky dokumentacion duhet përgatitur në përputhje me manualin e procedurave (PRAG i adaptuar nga Komisioni Evropian, versioni i fundit me shtojcat përkatëse), përveç pjesës që ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën që do t'u përshtatet specifikave të kredisë së ndihmës italiane, si dhe nga sa saktësohet në nenin 7 dhe në bashkëlidhjen 2.

Në çdo rast, dokumentacioni:

- duhet të specifikojë "kushtet e posaçme" në lidhje me çdo tender;

- duhet të shtjellojë qartë kriteret e vlerësimit që do të përdoren nga komisioni i ngritur nga MBUMK-ja.

Metodologjia

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Për sa i takon furnizimit të shërbimeve dhe të mallrave, MBUMK-ja do të procedojë përmes një tenderi dhe/ose prokurimi të drejtpërdrejtë me institucione publike italiane.

Dokumentacioni i tenderit, i përgatitur nga NJMP-ja, pasi verifikohet dhe/ose plotësohet nga MBUMK-ja, do të dërgohet më pas po nga NJMP-ja pranë MBUMK-së në Ambasadë/NJTL, së bashku me një kërkesë për shpalljen e njoftimit për tender në gazetën kryesore italiane dhe faqen e internetit të MPJ-së.

2. Verifikim i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i tenderit, pasi verifikohet dhe/ose plotësohet nga MBUMK-ja, do të dërgohet nga NJMP-ja pranë MBUMK-së në Ambasadë/NJTL, së bashku me kërkesën për shpallje të njoftimit për tender në gazetën kryesore italiane dhe në faqen e internetit të MPJ-së, për të verifikuar përputhshmërinë me këtë Marrëveshje. Ky verifikim do të bazohet, veçanërisht në përputhjen e:

- procedurës së tenderit me planin e prokurimit të miratuar;

- përmbajtjes me karakter ligjor me procedurat e treguara në bashkëlidhjen 2;

- teknikave specifike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi synon të arrijë.

Ambasada/NJTL do t'i dërgojë MPJ/DPBZH-së dokumentacionin e tenderit për të verifikuar sa në kompetencë të saj.

### 3. Shpallja e njoftimit

Në rast se verifikimi do të dilte me sukses, njoftimi për tender do të botohet nga MPJ/DPBZH-ja në gazetën kryesore italiane dhe në faqen e internetit të MPJ-së. MBUMK-ja do të vijojë njëkohësisht me shpalljen e njoftimit në gazetën kryesore kombëtare.

## SEKSIONI III FAZA TË SHPALLJES SË FITUESIT - PROCEDURA E APLIKUAR

Zhvillimi i tenderit/ave dhe verifikimi i përputhshmërisë së kritereve të përdorura nga komisioni i vlerësimit:

- MBUMK-ja, përmes NJMP-së, do të ndjekë ecurinë e tenderit, duke asistuar edhe komisionin e vlerësimit të ofertave (caktuar nga MBUMK-ja);

- pasi përfundon vlerësimi, përpara shpalljes zyrtare të fituesit, NJMP-ja do t'i kërkojë DPBZH-së të verifikojë përputhshmërinë e tenderit.

### Metodologjia

1. Shqyrtimi i ofertave të sjella për çdo tender do të kryhet nga komisioni i vlerësimit, i krijuar enkas nga MBUMK-ja. Në çeljen e ofertave dhe në çdo rast në të gjitha mbledhjet e hapura të komisionit të vlerësimit, mund të marrë pjesë një përfaqësues i caktuar nga Ambasada/NJTL në cilësinë e vëzhguesit. NJMP-ja pranë MBUMK-së do të ndjekë ecurinë e tenderit duke asistuar - kur do të jetë e nevojshme - edhe komisionin.

2. Për çdo tender, MBUMK-ja, përmes NJMP-së do t'i përcjellë Ambasadës/NJTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit për vlerësimin e ofertave, së bashku me kontratën që do të lidhet dhe kërkesën për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratave. Ky dokumentacion do t'i përcillet MPJ/DPBZH-së nga Ambasada/NJTL së bashku me komentet e mundshme.

3. MPJ-DPBZH-ja do të verifikojë kryesisht përputhje ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera

me procedura dhe kritere/parametra në kreun e kushteve teknike të tenderit. Pasi të përfundojnë këto verifikime, MPJ-DPBZH-ja do të informojë Ambasadën/NJTL për rezultatin e tyre.

4. Në rast rezultati pozitiv (asnjë pengesë), MBUMK-ja, e asistuar nga NJMP-ja, do të vijojë me lidhjen e kontratës me institucionin italian që ka rezultuar fitues.

## SEKSIONI IV FAZA TË MBËSHTETJES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMET - PROCEDURA E APLIKUAR

Kontratat që marrin formë zyrtare mes institucionit fitues dhe MBUMK-së, duhet të mbërrijnë në MPJ/DPBZH përmes Ambasadës/NJTL, së bashku me një deklaratë angazhimi të Palës shqiptare për të përballuar kostot lokale (tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrime doganore etj.).

### Metodologjia

1. Pasi merr dokumentacionin, MPJ-DPBZH-ja do të kujdeset të lëshojë miratimin për autorizimin e MFQ-së, që do ta mbështesë kontratën në Marrëveshjen Financiare.

2. MFQ-ja do të përfundojë fazën përgatitore, duke i kërkuar institucionit fitues që mallrat dhe shërbimet të jenë me origjinë italiane dhe se shpenzimet që duhen përballuar në vend nuk mund të kalojnë vlerën e përcaktuar në çdo kontratë. Njëkohësisht, MFQ-ja do t'i kërkojë kredimarrësit shqiptar dërgimin e kërkesës për vënie në dispozicion të fondeve, duke e njoftuar kredimarrësin edhe për dhënien e miratimit nga ana e DPBZH-së.

3. Pasi merr të gjithë dokumentacionin e përmendur në pikën e mësipërme 2, MFQ-ja do të njoftojë kredimarrësin dhe NJMP-në mbështetjen e kontratave në Marrëveshjen Financiare dhe mundësinë e financimit të tyre. Përfundimi i kësaj procedure do të bëjë të mundur livrimin e "paradhënies së pagesës" të parashikuar në çdo kontratë dhe do të përcaktojë datën e hyrjes në fuqi të saj.

4. Pagesat e tjera të mëvonshme mund të vendosen vetëm pas miratimit të NJMP-së për kryerjen e shërbimeve të parashikuara në çdo kontratë.

**LIGJ**  
**Nr. 10/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË**  
**SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR REALIZIMIN**  
**E PROGRAMIT “PROJEKTI PILOT PËR**  
**KRIJIMIN DHE EKSPERIMENTIMIN E NJË**  
**SISTEMI SIGURIMESH TË LEHTËSUARA PËR**  
**MBULIMIN E RREZIQEVE NË BUJQËSI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Projekt pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi sigurimesh të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.2.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8503, datë 24.2.2014 të**  
**Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË**  
**REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR REALIZIMIN E**  
**PROGRAMIT “PROJEKT PILOT PËR KRIJIMIN**  
**DHE EKSPERIMENTIMIN E NJË SISTEMI**  
**SIGURIMESH TË LEHTËSUARA PËR MBULIMIN E**  
**RREZIQEVE NË BUJQËSI”**

*Duke pasur parasysh se:*

- në datën 2 dhjetor 2008 është firmosur në Tiranë Marrëveshja kuadër e bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë (Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim) dhe qeveria e Shqipërisë (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), të dyja në vijim të quajtura “Palët”, kanë rënë dakord të

nënshkruajnë këtë Marrëveshje (këtu e në vijim e quajtur “Marrëveshja”);

- Protokollin dypalësh i Bashkëpunimit për Zhvillim 2010 - 2012, i firmosur në Tiranë, më 12 prill 2010, parashikon një financim kredie ndihme për shumën 10 milionë euro, për një “Program të modernizimit të sektorit të bujqësisë”, që përfshin tri nisma: i) krijimin e një skeme sigurimi në favor të ndërmarrjeve të vogla e të mesme bujqësore (SME-të); ii) mbështetjen për krijimin e Agjencisë së Pagesave - AZHBR”; dhe iii) fuqizimin e ullishtarisë;

- në datën 3.6.2011, me shkresë me nr. prot. 2533/1, Pala shqiptare ka përcjellë propozimin për projekt të quajtur “Projekt pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi të sigurimeve të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi”, duke i kërkuar me këtë rast Palës italiane një financim në shumën 2.000.000,00 euro;

- pas fazës përgatitore të Projektit, të kryer nga zyrat përgjegjëse të DPBZH-së, Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (MPJ-DPBZH) italiane në takimin e datës 8 qershor 2012 ka miratuar dhënien e një kredie ndihme prej 2.000.000,00 eurosh, për realizimin e nismës “Projekt pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi të sigurimeve të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi”, në vijim i quajtur “Programi”.

Sa më sipër u parashtrua, Palët kontraktuese bien dakord për sa vijon:

**Neni 1**

**Përmbajtja dhe përkufizimet në Marrëveshje**

1.1 Marrëveshja përbëhet nga 16 nene dhe nga bashkëlidhjet e mëposhtme:

“Bashkëlidhja 1” - Përmbledhje e Programit;

“Bashkëlidhja 2” - Kритere të zgjedhshmërisë, klauzola etike dhe parime të përgjithshme të kontratave;

“Bashkëlidhja 3” - Plani financiar;

“Bashkëlidhja 4” - Mënyra e ekzekutimit dhe e administrimit të kredisë së ndihmës.

1.2 Bashkëlidhjet e sipërpërmendura janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e Marrëveshjes.

1.3 Fjalët dhe akronimet e përmendura në tekstin në vijim kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Ambasada e Italisë”, Ambasada e Italisë në Tiranë.

“AT” - asistencë teknike e dhënë në kuadrin e Programit.

“Marrëveshje Financiare” – Marrëveshje midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Menaxhuesit të Fondit Qarkullues për financimin e Programit.

“Donator” - qeveria italiane.

“MFQ” - Menaxhues i Fondit Qarkullues: Instituti financiar italian, që menaxhon për llogari të Ministrisë

së Ekonomisë dhe Financave të Italisë fondet e kredisë së ndihmës, të parashikuara në Marrëveshje, apo ndryshe Artigiancassa.

“MBUMK” - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e Shqipërisë.

“MEF” - Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Italisë.

“MFSH” - Ministria e Financave e Shqipërisë.

“NJMP” - Njësia e Menaxhimit të Projektit.

“KD” - Komiteti Drejtues.

“NJTQ” - Njësia Teknike Qendrore e MPJ-DPBZH-së.

“NJTL” - Njësia Teknike Lokale - Zyra e Kooperacionit për Zhvillim e Ambasadës së Italisë në Tiranë.

#### Neni 2

### Qëllimi i Marrëveshjes

2.1 Kjo Marrëveshje synon të rregullojë angazhimet e ndërsjella të dy Palëve për realizimin e rregullt të Programit.

2.2 Për këtë qëllim, Marrëveshja sanksionon angazhimin e të dyja Palëve për respektimin e Programit, me vëmendje të veçantë ndaj afateve dhe kushteve për përdorimin e kredisë përkatëse.

#### Neni 3

### Përshkrimi i Programit

3.1 Programi, përmbledhja e shkurtër e të cilit tregohet në bashkëlidhjen 1, ka si objektivi të përgjithshëm të ndihmojë në stabilizimin e të ardhurave të popullsisë shqiptare që merret me bujqësi.

3.2 Objektivi specifik i Programit synon krijimin dhe eksperimentimin në nivel kombëtar të një sistemi sigurimesh të lehtësuara kundër rreziqeve të fatkeqësive natyrore, duke marrë si sektor pilot atë të vreshtarisë.

#### Neni 4

### Angazhime të qeverisë italiane

Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, angazhohet të financojë Programin me një shumë prej 2.000.000,00 eurosh si kredi ndihme, e cila do të jetë e disponueshme pranë Artigiancassa-s dhe do të livrohet sipas sa tregohet qartë në bashkëlidhjet 3 dhe 4.

#### Neni 5

### Angazhime të qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare angazhohet:

5.1 Të garantojë realizimin e Programit në përputhje me këtë Marrëveshje. Për këtë qëllim do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarive dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe angazhimet fillestare të përcaktuara në “kuadrin logjik” të Programit, siç tregohet në bashkëlidhjen 1;

5.2 Të bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për realizimin me sukses të Programit;

5.3 Të krijojë pranë MBUMK-së, që do të bëhet enti zbatues, NJMP (Njësia e Menaxhimit të Projektit), e cila do të kujdeset të bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe menaxhues, të nevojshme për realizimin e Programit;

5.4 Të japë bashkëpunim të plotë për MPJ-DPBZH-në për veprimtarinë e monitorimit të Programit dhe për aksesin në dokumentacionin ekzistues;

5.5 Të rimbursojë shumat e marra si kredi ndihme, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 8.

#### Neni 6

### Struktura të menaxhimit dhe realizimit të Programit

Struktura menaxhuese dhe mënyrat e realizimit të Programit, siç tregohet në hollësi në bashkëlidhjet 1 dhe 4, parashikojnë:

6.1 MBUMK-ja, që do të realizojë Programin, do të përgatisë të gjitha marrëveshjet e nevojshme me institucionet përgjegjëse, do të firmosë kontratat e kërkuara dhe do të jetë përgjegjëse për përdorimin e fondeve dhe për kredinë e ndihmës sipas mënyrave dhe procedurave të përcaktuara nga Marrëveshja Financiare;

6.2 MFSH-ja, që do të lidhë Marrëveshjen Financiare;

6.3 Komiteti Drejtues (KD) që do të vigjillojë mbi efikasitetin dhe eficiencën e Programit dhe do të kryejë të gjitha funksionet sipas sa përcaktohet në bashkëlidhjen 1. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shqiptare - MBUMK, nga një përfaqësues i MPJ-DPBZH-së edhe nëpërmjet Ambasadës së Italisë/NJTL dhe, në cilësinë e vëzhguesit, nga një përfaqësues i entit realizues;

6.4 Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP), që do të jetë operative për gjithë kohëzgjatjen e Programit dhe do të ngarkohet me zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe me bashkërendimin e të gjitha organeve të sipërtreguara, duke garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Marrëveshje;

6.5 MPJ-DPBZH-ja që do të sigurojë livrimin e burimeve financiare si kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni italian në fuqi, siç tregohen përmbledhtazi në këtë Marrëveshje. MPJ-DPBZH-ja, në bashkëpunim me MBUMK-në, do të ketë, gjithashtu, për detyrë të mbikëqyrë ecurinë e Programit. MPJ-DPBZH-ja do të veprojë përmes zyrave përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veta. Në veçanti, NJTQ-ja e MPJ-DPBZH-ja do të sigurojë të gjitha funksionet me karakter teknik në mbështetje të Programit;

6.6 Artigiancassa, që, sipas udhëzimeve të MPJ-DPBZH-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

italiane, do të lidhë me Ministrinë e Financave Shqiptare një Marrëveshje Financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve si kredi ndihme. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financiare, Artigiancassa do të livrojë kredinë sipas përcaktimeve të nenit 9 dhe në lidhjen 3 të kësaj Marrëveshjeje, sipas modaliteteve dhe procedurave, të specifikuar në këtë Marrëveshje Financiare;

6.7 Ambasada/NJTL në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e nevojshme me karakter teknik dhe do të garantojë ecurinë e rregullt të veprimtarive. Në kuadrin e funksioneve të veta institucionale, Ambasada/NJTL do të sigurojë, gjithashtu, kontaktet e nevojshme me palët partnere të Programit, duke u kujdesur, ndër të tjera, për marrjen dhe përcjelljen e gjithë dokumentacionit zyrtar.

#### Neni 7

##### **Afate dhe kushte të kredisë së ndihmës**

Kushtet financiare të kredisë së ndihmës parashikojnë afatet e mëposhtme:

- kohëzgjatja: 26 vjet, nga të cilat 16 vjet periudhë pa pagesë;

- përqindja e interesit: 0,0 %.

Në bazë të kushteve aktuale financiare, kredia e ndihmës parashikon lehtësira në masën 60%.

#### Neni 8

##### **Mënyrat e përdorimit të kredisë së ndihmës dhe procedurat e përcaktimit të përfituesit**

Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ-DPBZH-së, ashtu siç tregohet në hollësi në bashkëlidhjen 4, hapat kryesorë që duhen ndjekur për përdorimin e fondit si kredi ndihme, janë si vijon (tregohen më qartë në bashkëlidhjen 4):

8.1 Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje të Programit, që përmbledh përmbajtjen e nismës, përcakton angazhimet e Palëve në realizimin e ndërhyrjes dhe hapat e mëtejshëm operativë;

8.2 Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave italiane, me propozim të MPJ-së, e një dekreti ministror që autorizon Menaxhuesin e Fondit Qarkullues, bankën Artigiancassa, të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen Financiare me Ministrinë e Financave shqiptare (MFSH);

8.3 Lidhja e Marrëveshjes Financiare mes Artigiancassa-s dhe MFSH-së;

8.4 Krijimi i organeve menaxhuese të Programit;

8.5 Përgatitje e dokumentacionit të tenderit, nga ana e NJMP-së, rezervuar subjekteve italiane publike dhe private. Në rast veprimtarish specifike të asistencës teknike institucionale, MBUMK-ja, kur është e mundur, do të veprojë me prokurim të drejtpërdrejtë për institucionet publike italiane;

8.6 Verifikim kompetence, nga ana e MPJ-DPBZH-së, i dokumenteve të përgatitura të tenderit;

8.7 Në rast rezultati pozitiv, kryerjen e tenderave të mësipërm dhe shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit, të krijuar nga ministria kompetente shqiptare dhe shpalljen e fituesit;

8.8 Verifikim i përputhshmërisë nga ana e MPJ-DPBZH-së e procedurës së ndjekur për përzgjedhjen dhe i kontratës që duhet lidhur dhe, në rast rezultati pozitiv, lidhja e kontratës së shërbimit e të furnizimeve nga ana e ministrisë përgjegjëse shqiptare;

8.9 Mbështetje e kontratave të veçanta, të lidhura dora-dorës në Marrëveshjen Financiare.

Prokurimi i shërbimeve, i punimeve dhe i furnizimeve për realizimin e Programit, do të kryhet përmes kryerjes së tenderave të rregulluar nga dispozitat që përmban versioni i fundit i Manualit të Procedurave (PRAG) i përfutur nga Komisioni Evropian - dhe shtojcat përkatëse, i përfutur me ligjin nr. 49/87, ashtu siç tregohet në bashkëlidhjen 2.

Do të mund të kryhen shpenzime në vend deri në një maksimum prej 75% të shumës së kredisë.

#### Neni 9

##### **Kushte financiare dhe mënyra të livrimit të kredisë së ndihmës**

Kredia e ndihmës do të livrohet në dy mënyra të ndryshme, sipas tipit të shpenzimeve, siç përcaktohet në bashkëlidhjet 3 dhe 4:

A. - Për shpenzime të bëra drejtpërsëdrejt nga enti zbatues (MBUMK), mënyra do të jetë si vijon:

9.1 Transhi i parë, i barabartë me 15% të shumës së treguar në zërin ref. A të bashkëlidhjes 3, do të livrohet me kërkesë të MBUMK-së për MFQ-në, pasi të përmbushen parakushtet e mëposhtme:

- nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare mes MFSH-së dhe MFQ-së;

- krijimi i organeve të administrimit të Programit;

- përzgjedhja e shoqërisë së auditimit.

9.2 MBUMK-ja me ndihmën e NJMP-së do të paraqesë kërkesë për transhin e dytë, baras me 50% të shumës së treguar në bashkëlidhjen 3, ref. A, pas miratimit dhe përfutimit të legjislacionit referues, kur të jetë provuar se është angazhuar 80% e shumës së transhit të parë dhe të jetë livruar konkretisht 40% e tij dhe të jetë kryer kontrolli i mëpasshëm i një shoqërie auditimi. MBUMK-ja do t'i bashkëlidhë kërkesës një raport të detajuar të saj dhe të certifikuar nga shoqëria e auditimit, i cili do të evidentojë vlefshmërinë e çdo veprimi. Livrimi i transhit do të bëhet pas verifikimit me sukses të këtij raporti nga ana e MFQ-së, përveç sa vendosur në pikën 9.5. MFQ-ja do të kujdeset të njoftojë MPJ-DPBZH-në në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

9.3 Kur MBUMK-ja do të ketë angazhuar shuma për një vlerë më të madhe se 80% e totalit të livruar me transhin e parë dhe të dytë, dhe të ketë livruar konkretisht 40% të tyre, MBUMK-ja, me mbështetjen e NJMP-së, do të bëjë kërkesë për transhin e tretë baras me 35%, duke paraqitur një raport të detajuar dhe të certifikuar nga shoqëria e auditimit. Livrimi i transhit varet nga rezultati pozitiv i verifikimit të këtij raporti nga ana e MFQ-së, përveç sa vendoset në pikën 9.5. MFQ-ja do të kujdeset të njoftojë MPJ-DPBZH-në në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi.

9.4 Në përfundim të të gjitha veprimeve, MBUMK-ja do të paraqesë një raport përfundimtar, të certifikuar nga shoqëria e auditimit. Ky raport do të duhet të miratohet nga MPJ-DPBZH-ja dhe nga MFQ-ja, përveç sa vendosur në pikën 9.5.

9.5 Qeveria shqiptare angazhohet në mënyrë të pakthyeshme t'i rimbursojë MFQ-së fondet që do të konsiderohen si të papërdorura kurrë, në rastin kur kontrolli i kryer nga shoqëria e auditimit mbi dokumentacionin kontraktor do të kishte rezultat negativ.

B. - Për shpenzime të kryera me fitim tenderi për furnizim shërbimesh, punimesh dhe mallrash (bashkëlidhja 3, ref. B), livrimi do të bëhet sipas mënyrës së përshkruar në bashkëlidhjen 4, seksioni IV.

#### Neni 10

##### **Veprimtari të monitorimit dhe të kontrollit**

Palët angazhohen të kryejnë gjithë sa është e nevojshme për arritjen e objektivave të Programit dhe për të monitoruar e për të kontrolluar vazhdimisht përdorimin e fondeve dhe çdo kusht tjetër të përmendur në Marrëveshje. Në veçanti, arritja konkrete e objektivave do të vlerësohet kohë pas kohe në përputhje me skemën e treguesve që përmban "kuadri logjik" në bashkëlidhjen 1, gjatë mbledhjeve të takimit të Komitetit Drejtues.

Vlerësime të mundshme gjatë rrugës dhe përfundimtare do të bëhen nën kujdesin e DPBZH-së. Ato do të bëhen në bashkëpunim me njësinë e MBUMK-së, e cila do të ngarkohet me monitorimin e projekteve që përfitojnë financime ndërkombëtare.

#### Neni 11

##### **Klauzola kundër korrupsionit**

Qeveria e Republikës së Italisë është angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij. Në veçanti, me qëllim që të shmangët çdo mundësi për veprimtari të paligjshme dhe parregullsi gjatë paraqitjes së ofertave për furnizime, shërbime dhe punime civile, qeveria italiane ka parashikuar detyrimin për të gjithë pjesëmarrësit në tendera që të nënshkruajnë dhe të paraqesin shtojcën *Integrity Pact* (Pakti i

Integritetit) së bashku me ofertat e tyre ose me kontratat e miratuara. Mosparaqitja e dokumentacionit të mësipërm do të sjellë automatikisht përjashtimin nga tenderi ose do të përbëjë arsye për të zbatuar sanksionet përkatëse të *Integrity Pact*, në rast mosrespektimi të angazhimeve kundër korrupsionit gjatë zbatimit të kontratës. Vendosja e kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë të rregullt dhe shanse të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe një zbatim të rregullt dhe transparent të kontratës së miratuar.

#### Neni 12

##### **Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshje që mund të lindin gjatë zbatimit të Programit, duhet të zgjidhen me mirëkuptim përmes konsultimeve mes MBUMK-së dhe MPJ-DPBZH-së nëpërmjet Ambasadës së Italisë.

#### Neni 13

##### **Pengesa dhe forca madhore**

Në rast pengese për realizimin e Programit, për shkak forcash madhore (luftë, përmytje, zjarr, stuhi, tërmet, konflikte pune, greva, akte të qeverive përkatëse, vështirësi të paparashikuara në transporte dhe shkaqe të tjera), të njohura nga të dyja Palët, ose në rast rreziku ose kushtesh të rrezikshme për personelin e transferuar jashtë atdheut, do të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

13.1 Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më e vogël se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara ndërpritet deri kur MPJ-DPBZH-ja do të autorizojë rifillimin e veprimtarive;

13.2 Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se gjashtë muaj dhe më e vogël se njëzetekatër, Programi pezullohet dhe fondet e papërdorura ruhen deri sa të mos ekzistojë më pengesa dhe të ketë mbërritur autorizimi i DPBZH-së për rifillimin e veprimtarisë;

13.3 Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se gjashtë muaj dhe më e vogël se njëzetekatër muaj, Palët janë të detyruara të merren vesh për vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë veprimet e mëtejshme. Në rast pamundësie për të vazhduar veprimtarinë, Palët duhet të vendosin mbi përdorimin e fondeve të papërdorura. Në mungesë të një marrëveshjeje, Pala shqiptare angazhohet të rimbursojë shumat e mbetura.

#### Neni 14

##### **Denoncimi i Marrëveshjes**

Palët ruajnë të drejtën të denoncojnë këtë Marrëveshje nëse do të vërtetohej një prej rasteve të mëposhtme:

14.1 Mosrealizim i objektivave të parashikuar në Program për shkaqe që nuk kanë të bëjnë me Palën italiane;

14.2 Gabim i rëndë nga ana e MBUMK-së, si vonesa të pajustificuara dhe të zgjatura në kohë (më të mëdha se nëntë muaj) të tilla që do të vinin në rrezik arritjen e objektivit të Programit, përdorim i fondeve për arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen Financiare, vonesë e zgjatur në paraqitjen e raporteve të parashikuara;

14.3 Pengesë ose forcë madhore e zgjatur në kohë, sipas sa përcaktohet në klauzolat e nenit të mësipërm 13;

14.4 Në rast gabimi të rëndë, si në pikën 14.2, MPJ-DPBZH-ja duhet të njoftojë me shkrim për sa ka ndodhur MBUMK-në, duke e ftuar të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda një periudhe maksimale prej 90 ditësh nga data e njoftimit. Pas mbarimit të këtij afati, MPJ-DPBZH-ja ruan të drejtën të denoncojë Marrëveshjen;

14.5 Në të dyja rastet e tjera të sipërpërmendura, MPJ-DPBZH-ja mund të vendosë në mënyrë të njëanshme denoncimin e Marrëveshjes, duke e njoftuar MBUMK-në me një notë verbale, të paktën 3 muaj më parë. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MBUMK-ja është e detyruar të ndërpresë veprimtaritë e Programit, përveçse kur është rënë dakord ndryshe mes Palëve.

#### Neni 15 Ndryshimi

Palët mund të propozojnë ndryshime në Marrëveshje përmes shkëmbimit të notave verbale. Ndryshimet për të cilat Palët mund të bien dakord do të hyjnë në fuqi sipas procedurave përkatëse të brendshme të parashikuara sipas rastit.

#### Neni 16 Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Çdo Palë duhet ta njoftojë me shkrim Palën tjetër në lidhje me përfundimin e procedurave kombëtare, të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të fundit.

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje do të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e kredisë.

Në besim të sa më sipër, të nënshkruarit përfaqësues, rregullisht të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

U nënshkrua në Tiranë, më 12.12.2012, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët italiane dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën italiane.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:  
MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT

**Genc Ruli**

Për qeverinë e Republikës së Italisë:  
AMBASADORI I ITALISË NË TIRANË

**Massimo Gaiani**

## BASHKËLIDHJA 1

### PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PROGRAMIT “KRIJIMI DHE EKSPERIMENTIMI I NJË SISTEMI SIGURIMESH TË LEHTËSUARA PËR MBULIMIN E RREZIQEVE NË BUJQËSI”

#### OBJEKTIVA TË PROGRAMIT

Ndërhyrja ka si objektiv të përgjithshëm përmirësimin e kushteve të jetës së popullsisë që merret me bujqësi nëpërmjet stabilizimit të të ardhurave familjare, që vijnë nga veprimtari bujqësore, edhe në rast ngjarjesh fatkeqësish natyrore.

Në veçanti, qëllimi i ndërhyrjes është krijimi dhe eksperimentimi në nivel kombëtar i një sistemi sigurimesh bujqësore të lehtësuara. Për këtë qëllim, është e nevojshme ndërfitja e një mekanizimi, i cili, nëpërmjet ndihmave shtetërore, të mund të kryejë transferimin e shpenzimit publik nga *ex-post*, i pasigurt në “an” dhe në “quantum”, në *ex-ante*, i sigurt dhe i përcaktueshëm që më parë, me rrjedhojë transferimin e paqëndrueshmërisë së riskut në tregun e sigurimeve, i cili merr përsipër të likuidojë ngjarjet e mundshme të fatkeqësive natyrore brenda një kohe të shkurtër për të mundësuar kështu vazhdimësinë operative të sektorit të bujqësisë.

Duke pasur parasysh karakterin pilot të nismës, është zgjedhur sektori i vreshtarisë si segment pilot ku do të nisë eksperimentimi i sistemit të sigurimeve të lehtësuara.

#### REZULTATET E PRITSHME

Rezultatet që synon të arrijë Projekti, janë si vijon:

1. Përcaktim i kuadrit ligjor referues për stimujt sigurues në bujqësi

Në përputhje me objektivit e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është e domosdoshme që legjislacioni për stimujt sigurues, i cili do të duhet të përftohet përpara nisjes së eksperimentimit, të jetë në përputhje me kufizimet e përcaktuara nga kuadri rregullues evropian në lidhje me ndihmat e shtetit për mbulimin e risqeve klimaterike dhe fitopatologjike, në të mbjella dhe në struktura prodhuese, dhe epizootike në fermat zooteknike.

2. Krijimi i një banke të dhënash dhe furnizim i stacioneve meteorologjike

Me qëllim që të përcaktohet risku, pra edhe primi i sigurimit, është e udhës të vihen në një emërues të përbashkët të dhënat meteorologjike të rilevuara gjatë viteve dhe të krijohet një sistem rilevimi në territor për ngjarjet meteorologjike, duke investuar mbi të gjitha në ato zona gjeografike ku janë përqendruar prodhimet më të mëdha të rrushit për verë.

3. Krijim i tregut të sigurimeve për lehtësime në bujqësi

Duke pasur parasysh faktin se policat e sigurimit lëshohen nga shoqëritë e sigurimit, është e udhës t'u jepet asistencë operatorëve lokalë dhe mbështetje teknike për administrimin e policave dhe tregun në sektorin e ri në fjalë. Për këtë qëllim, projekti synon të krijojë një grup pune, i cili do të shqyrtojë një policë sigurimi për t'u shpërndarë më pas ndër prodhuesit e rrushit për verë, do të përcaktojë, si objektin e sigurimit ashtu dhe përqindjen e primit, që do t'u kërkohet fermerëve të përqindjen e primit, që do t'u kërkohet fermerëve të paguajnë. Gjithnjë në këtë kuptim, dhe me qëllim që të mbahet disi e ulët kostoja e policës së sigurimit, është tejet i rëndësishëm risigurimi shtetëror, që kryen detyrën e dhomës së kompensimit mes shoqërive të sigurimit shqiptare dhe, sipas rastit, risiguruesve ndërkombëtarë.

Kushti i detyrueshëm, që duhet përmbushur përpara krijimit të fondit shtetëror për kontributet mbi primit e sigurimit dhe të fondit të risigurimit, është se kuadri ligjor referues, i përgatitur në kuadrin e kësaj nisme, duhet të miratohet dhe të përftohet nga qeveria shqiptare.

#### VEPRIMTARI QË SYNOJNË ARRITJEN E REZULTATEVE

Për arritjen e rezultateve, si më sipër treguar, parashikohet të realizohen veprimtaritë e mëposhtme:

a) Shërbime të asistencës ligjore, teknike/të specializuar dhe trajnimi për eksperimentimin dhe krijimin e një tregu të sigurimeve bujqësore të lehtësuara kundër risqeve të fatkeqësive klimaterike, siç përshkruhet në Program;

b) Furnizim me pajisje teknike për realizimin e një rrjeti meteorologjik;

c) Krijimin e një fondi shtetëror për kontributet mbi primit e sigurimit bujqësor dhe të një fondi të risigurimit;

d) Shërbime të asistencës me natyrë teknike për MBUMK-në për zhvillimin e tenderave dhe realizimin e Programit.

Programi parashikon një sërë masash të nevojshme për të siguruar administrimin e rregullt të tij:

i) Do të krijohet në kuadrin e MBUMK-së një NJMP, e cila do të shfrytëzojë mbështetjen teknike dhe financiare të vetë Programit;

ii) Do të krijohet një Komitet Drejtues (KD), orientimi dhe kontrolli, që do të duhet të sigurojë udhëheqjen strategjike të Programit;

iii) Do të vihen në dispozicion nga ana e MPJ/DPBZH-së, burime për kontrole dhe/ose vlerësime të Programit nëse do të shiheshin të nevojshme;

iv) Do të sigurohen, nga ana e MBUMK-së, burimet e nevojshme për mbulimin e disa kostove lokale (taksa, detyrime doganore etj.).

KD-ja në fjalë, që do të mblidhet çdo gjashtë muaj dhe sidoqoftë sa herë që do të shihej e nevojshme me

kërkesë të njërit prej anëtarëve të vet, do të ketë detyrat e mëposhtme:

- Drejton dhe mbikëqyr ecurinë e Programit;

- Miraton dhe vleftëson procedurat e administrimit të Programit;

- Miraton, gjatë mbledhjes së parë, kushtet referuese në lidhje me institucionin publik italian që duhet përzgjedhur dhe ekspertët italianë që ky i fundit do të vërë në dispozicion;

- Vendors politikat e përgjithshme dhe orienton drejt zgjedhjeve strategjike;

- Ndihmon shkëmbimin e përvojave dhe të kontakteve ndërmjet aktorëve dhe zbatuesve;

- Lehtëson integrimin me projekte dhe veprimtari të tjera, që nxisin sinergji pozitive dhe konstruktive, duke shmangur ndërhyrje të kryera nga nisma të tjera;

- Miraton planet operative, raportet teknike dhe financiare, të përgatitur nga NJMP-ja.

Gjatë mbledhjes së Komitetit, NJMP-ja do të kryejë detyrën e sekretariatit teknik.

#### BASHKËLIDHJA 2

#### KRITERE TË ZGJEDHSHMËRISË, KLAUZOLA ETIKE, PARIME TË PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

Kjo bashkëlidhje harmonizon versionin e fundit të "Normave dhe procedurave në lidhje me përfitim e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punimeve për kontrata të financuara me bilancin e përgjithshëm të Komisionit Evropian në kuadrin e programeve të bashkëpunimit me vendet e treta", me parimet themelore të legjislacionit italian në lidhje me veprimtaritë e "prokurimit" dhe ndihmës për zhvillim. Gjithashtu, ai duhet përfshirë edhe në kuadrin e parimeve themelore të legjislacionit të vendit përfitues në fushën e prokurimeve.

##### 1. ZGJEDHSHMËRIA E KONTRAKTUESIT

###### 1.1 Rregulla objektiviteti dhe asnjansie

Për të shmangur çfarëdo konflikti interesi, çdo person fizik ose juridik (përfshirë këtu subjekte që i përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë konsorciumesh, bashkime të përkohshme shoqërisht dhe nënkontraktuesish), që mund të ketë marrë pjesë në përgatitjen e Projektit, duhet përjashtuar nga tenderi ose nga paraqitja e ofertave për realizimin e tij.

1.2 Rregulla për kapacitetin ekonomik, financiar, profesional dhe teknik

Kandidatët/konkurrentët duhet të provojnë që kapacitetet e tyre ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike janë të përshtatshme për realizimin e veprimtarive të parashikuara në kontratë. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në Marrëveshje, kandidatët /konkurrentët duhet të provojnë:



1.2.1 Kapacitet ekonomik dhe financiar. Totali i faturuar nga kandidatët/konkurrentët në tri vitet e mëparshme, për të njëjtën kategori objekt të prokurimit, duhet të jetë të paktën i barasvlershëm me shumën maksimale të kontratës; shoqëritë që kanë më pak se tre vjet jetë mund të provojnë kapacitetin e vet ekonomik dhe financiar me çdo dokument që porositësi do ta shihte të përshtatshëm, i cili do të tregojë në rregulloren e tenderit;

1.2.2 Kapacitet teknik dhe profesional. Kandidatët/konkurrentët duhet të përgatisin një raport të plotë të veprimtarive të realizuara gjatë tri viteve të mëparshme; shoqëritë e krijuara që kanë më pak se tre vjet jetë mund të provojnë kapacitetin e tyre teknik dhe profesional me çfarëdolloj dokumenti që porositësi do ta shihte të përshtatshme, që do të përcaktohet në rregulloren e tenderit;

1.2.3 Për kontratat e punës, kandidatët/konkurrentët italianë duhet të fitojnë kualifikimin në përputhje me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 34/2000 (dhe ndryshimet ose amendamentet e mëvonshme të tij). Kandidatët/konkurrentët joitalianë duhet të fitojnë kualifikimet në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare.

1.3 Shkaqe për përjashtim nga pjesëmarrja në tender  
Përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe as nuk mund të shpallen fitues apo të lidhin kontratat përkatëse, personat fizikë ose juridikë, që:

1.3.1 Gjenden në një prej rrethanave të përmendura në dekretin legjislativ italian të datës 8.8.1994, nr. 490 ("Antimafia"). Kandidatët/konkurrentët italianë duhet të paraqesin "vërtetimin antimafia" të lëshuar nga autoritetet italiane kompetente. Kandidatët/konkurrentët joitalianë duhet të paraqesin dokumentacion të njëjtë, nëse parashikohet nga legjislacionet përkatëse kombëtare.

1.3.2 Janë në gjendje falimentimi ose në likuidim të detyruar ose gjenden në administrim gjyqësor, ose në procedurë për shlyerje kreditorësh, ose kanë ndërprerë veprimtaritë e tyre, ose gjenden në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga kuadri ligjor ose nënligjor kombëtar.

1.3.3 U janë nënshtruar procedurave të shpalljes së falimentimit ose likuidimit të detyruar, administrimit të kontrolluar, ose procedurës për shlyerje të kreditorëve, ose ndodhen në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar.

1.3.4 Ato ose drejtuesit e tyre, ose partnerët/ortakët, janë dënuar për një krim në lidhje me sjelljen profesionale, me një vendim të formës së prerë;

1.3.5 Janë fajtorë për sjellje të keqe profesionale të provuar me çfarëdolloj mjete që porositësi është në gjendje të përdorë.

1.3.6 Nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore me pagesën e sigurimeve shoqërore të parashikuara nga legjislacioni i vendit ku kanë selinë ligjore dhe/ose u kërkohet të punojnë.

1.3.7 Nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni i vendit ku kanë selinë ligjore dhe/ose ku u kërkohet të punojnë.

1.3.8 Janë fajtorë për deklarata të rreme në dhënien e informacioneve të kërkuara nga MPJ/DPBZH-ja si kusht për pjesëmarrjen në një procedurë tenderi ose për shpalljen fitues të një kontrate.

1.3.9 Kanë pësuar zgjidhje të një kontrate të mëparshme për mospërmbushje, në kuadrin e një kontrate tjetër me MPJ/DPBZH-në dhe/ose financim me fonde italiane.

## 2. PARIME TË PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

2.1 Prokurimi dhe realizimi i veprave dhe i punimeve publike, shërbimeve dhe furnizimeve, në bazë të këtij kodi, duhet të garantojë cilësinë e shërbimeve dhe të kryhet në respektim të parimeve të leverdisë ekonomike, efikasitetit, shpejtësisë dhe rregullsisë; prokurimi duhet, gjithashtu, të respektojë parimet e konkurrencës së lirë, të trajtimit të barabartë, të mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe çdo herë që të jetë e mundur, atë të të bërit publik.

2.2 Pas një marrëveshjeje paraprake mes Palëve, parimi i leverdisë ekonomike mund t'u nënshtrohet nevojave sociale, si dhe mbrojtjes së shëndetit dhe të mjedisit dhe nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

2.3 Procedura e prokurimit duhet të anulohet nëse ka më pak se tre kandidatë/ofertues të përshtatshëm.

2.4 Duhet të sigurohet e drejta e aksesit në dokumentacionin administrativ të përgatitur nga institucioni prokurues, me përjashtimet e mëposhtme:

- informacione të ofertuesve që përbëjnë sekrete teknike ose tregtare, dëshmi apo vërtetime për to me vetëdeklarim të arsyetuar ose të provuar;

- opinione ligjore të marra nga institucioni prokurues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ardhshme ose të tanishme;

- relacione konfidenciale të subjektit përgjegjës për kryerjen e punimeve ose të organit kolaudues për kërkesat ose rezervat e ekzekutuesit të kontratës.

2.5 Kontratat nuk mund të ndryshohen pa një miratim të qartë paraprak të MPJ/DPBZH-së, dhe në çdo rast mund të bëhen ndryshime vetëm në respektim të klauzolave të mëposhtme. Fituesit e kontratës nuk kanë të drejtë për pagesa ose rimbursime të asnjë lloji për veprimtari të realizuara pa autorizimin paraprak. Nëse MPJ/DPBZH-ja ose porositësi do ta kërkonin, fituesit të kontratës do t'i duhet që me shpenzime të vetat të rikthejë gjendjen në kushtet e mëparshme.

2.6 Ekzekutuesi i kontratës duhet të përbëjë një garanci dorëzanie për të siguruar dëmshpërblimin për dëme të mundshme që rrjedhin nga një zbatim i keq ose i pjesshëm i kontratës. Ai duhet, gjithashtu, të lidhë një policë sigurimi për dëme që mund të shkaktohen gjatë zbatimit të kontratës.

2.7 Dokumentacioni i tenderit duhet të specifikojë bazën e ankandit për kontratën që do të shpallet fituese.

2.8 Ndryshime të kontratave të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve janë të vlefshme vetëm pasi të jetë dhënë autorizimi i MPJ/DPBZH-së, që mund të jepet vetëm në këto raste:

2.8.1 Për nevoja që rrjedhin nga dispozita ligjore dhe nënligjore që dalin pas lidhjes së kontratës;

2.8.2 Për rrethana të paparashikuara dhe të paparashikueshme, përfshirë këtu mundësinë e përdorimit të materialeve të reja, komponentëve dhe teknologjive që nuk ekzistojnë në kohën kur ka nisur procedura e tenderit, me kusht që ato të përmirësojnë cilësinë e produktit ose të shërbimit, pa rritur për këtë arsye shumën e përgjithshme të kontratës;

2.8.3 Kur ndodhin ngjarje që lidhen me natyrën ose cilësinë e mallrave ose të vendeve në të cilat ndërhyhet, gjatë zbatimit të kontratës dhe që nuk do të ishin të parashikueshme në kohën e lidhjes së kontratës;

2.8.4 Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, ndryshimet e sipërpërmendura nuk do të mund të rrisin ose të ulin më shumë se 20% shumën e përgjithshme të kontratës;

2.8.5 Pranohen, gjithashtu, ndryshime që, në interesin e vetëm të porositesit, do të sillnin një rritje ose një ulje të shërbimeve të fituesit të kontratës deri në një maksimum prej 5% të totalit të kontratës, me kusht që ato të kenë si qëllim përmirësimin ose funksionimin më të mirë të shërbimeve objekt i kontratës, të mos sillnin ndryshime thelbësore dhe burimet financiare shtesë të jenë të disponueshme; këto ndryshime mund të arsyetohen vetëm nga nevoja objektive, që rrjedhin nga rrethana që janë shfaqur ndërkohë dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së kontratës;

2.8.6 Fituesit e kontratës janë të detyruar t'u nënshtrohen varianteve, si më sipër, treguar në të njëjtat kushte të kontratës;

2.8.7 Në çdo rast, fituesit e kontratës kanë për detyrë të zbatojnë të gjitha variantet me karakter thelbësor që do të konsiderohen të nevojshme nga porositesi, me kusht që ato të mos ndryshojnë në thelb natyrën e veprimtarive objekt i kontratës dhe të mos sjellin shpenzime më të mëdha.

2.9 Variantet e kontratave të punës janë të vlefshme vetëm pas një autorizimi paraprak të MPJ/DPBZH-së, që do të mund të jepet vetëm në rastet e mëposhtme:

2.9.1 Për nevoja që rrjedhin nga dispozita ligjore dhe nënligjore që nxirren pas lidhjes së kontratës;

2.9.2 Për shkaqe të paparashikuara dhe të paparashikueshme ose sepse ndërkohë është shfaqur mundësia e përdorimit të materialeve, komponentëve dhe teknologjive që nuk ekzistojnë në kohën e projektimit e që mund të sjellin, pa rritje kostoje, përmirësime të ndjeshme në cilësinë e veprës ose të

pjesëve të saj dhe gjithnjë nëse nuk do të ndryshonin impostimin e projektit fillestar;

2.9.3 Për shkak të ekzistencës së ngjarjeve që kanë të bëjnë me natyrën dhe specifikat e mallrave në të cilat ndërhyhet e që kanë ndodhur gjatë kryerjes së punimeve, ose të rrethanave të paparashikuara ose të paparashikueshme në fazën e Projektit;

2.9.4 Probleme gjeologjike të paparashikueshme në projekt-zbatimin;

2.9.5 Për shkak të shfaqjes së gabimeve ose mosveprimeve në Projektin e zbatimit, të cilat do të vinin në rrezik, tërësisht ose pjesërisht, realizimin e veprës apo përdorimin e saj; në këtë rast, mbajtësit e detyrave të projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësuar nga institucionet prokuruese; fituesit e kontratës nuk do të mund të mos pranojnë këto ndryshime, me kusht që kostoja e tyre të mos kalojë 20% të vlerës së totalit të kontratës;

2.9.6 Ndryshime që, në interesin e porositesit, sjellin një rritje ose një ulje të shërbimit të ofruar nga fituesi i kontratës deri në një maksimum prej 5% të totalit të kontratës, dhe që do të ishin të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e veprave/punimeve, pranohen me kusht që burimet financiare shtesë të jenë të disponueshme;

2.10 Kontratat nuk mund t'u kalohen të tretëve, pasi kjo do të sillte zgjidhjen me të drejtë të kontratave të dhëna më parë.

2.11 Nënshpërmarrja pranohet deri në një maksimum prej 30% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumentacioni i tenderit duhet të saktësojë nëse nënshpërmarrja lejohet dhe, nëse po, të përcaktohen kushtet përkatëse. Konkurrentët duhet të deklarojnë, në ofertat e tyre, se cilët furnitorë/shërbime/punime mendojnë të punojnë me nënshpërmarrje. Fituesit e kontratës duhet të depozitojnë kontratat përkatëse të nënshpërmarrjes pranë institucionit prokurues, të paktën 20 ditë përpara fillimit të punimeve objekt i nënshpërmarrjes. Nënshpërmarrësit duhet të jenë të zgjedhshëm për furnizimet/shërbimet/punimet që do të duhet të realizojnë, sidomos në lidhje me kushtet që përmbajnë paragrafët nga 1.3.1 në 1.3.7 të kësaj bashkëlidhjeje.

2.12 Çmimet e kontratës janë fikse dhe nuk mund të rishikohen.

2.13 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen vetëm në euro. Risqe dhe ndryshime të kursit të këmbimit nuk i nënshtrohen asnjë kompensimi.

2.14 Kontrata zgjidhet me të drejtë nëse fituesit e saj u nënshtrohen procedurave të falimentimit, ose likuidimit të detyruar, administrimit gjyqësor ose procedurës së shlyerjes së kreditorëve, ose nëse ndodhen në një rrethanë çfarëdo të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni përkatës kombëtar.

2.15 Në rast faji ose gabimi të rëndë, nuk pranohet kufizimi i përgjegjësisë së fituesve të kontratës.

2.16 Zbatimi i kontratës rregullohet nga ligji i vendit përfitues.

2.17 Institucioni prokurues duhet të emërojë një përgjegjës për zbatimin e kontratës, me detyra kontrolli dhe bashkëpunimi me fituesin e kontratës dhe të garancisë që të mbrohet interesi publik i ekzekutimit të objektit të kontratës me cilësinë më të mirë dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.18 Mosmarrëveshjet që do të lindnin mes fituesve të kontratës dhe institucionit prokurues nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

2.19 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e sipërpërmendura.

2.20 Në rastin e një boshllëku ligjor, Pala Italiane ruan të drejtën të zbatojë parimet themelore të legjislacionit italian.

### 3. KOSTO TË PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME

3.1 Kostot e nxjerra në kontrata janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për realizimin e Projektit sipas dokumentit të Projektit.

3.2 Në çdo rast, kostot përkatëse të këtyre mallrave/shërbimeve/punimeve nuk konsiderohen të pranueshme:

a) mallra jo të domosdoshme apo luksi (p.sh.: parfume, artikuj kozmetikë, vepra arti, pije alkoolike, artikuj sportivë etj.);

b) mallra, shërbime dhe punime civile që lidhen drejtpërsëdrejt ose tërthorazi me veprimtari ushtarake dhe të policisë;

c) të gjitha taksat dhe tatimet indirekte (përfshirë TVSH-në) dhe të drejtat doganore;

d) amortizime të borxheve të marra më parë dhe humbjeve të ardhshme të përfituesit ose të përdoruesve të fundit;

e) interesa që u detyrohen të tretëve nga ana e përfituesit ose përdoruesve të fundit.

### 4. KLAUZOLA ETIKE

4.1 Çdo përpjekje e bërë nga ana e konkurrentëve (të mundshëm dhe jo), për të marrë informacione konfidenciale, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë, ose për të ndikuar institucionin prokurues në fazat e shqyrtimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, do të shpjerë në përjashtimin nga tenderi të konkurrentit/ëve, dhe në eliminimin, për rrjedhojë, të ofertës së tij/tyre, përveç aplikimit të sanksioneve administrative.

4.2 Pa autorizimin paraprak me shkrim të autoritetit prokurues, fituesit e kontratës dhe personeli i tyre, apo cilado shoqëri/sipërmarrje me të cilën do të bashkohej ose lidhej fituesi i kontratës nuk do të mund të realizojnë, as në formë plotësimi apo nësipërmarrjeje,

punime apo të furnizojnë mallra në kuadrin e kësaj kontrate. Ky ndalim gjen zbatim për çdo projekt, që për shkak të natyrës së kontratës do të shpinte në lindjen e një konflikti interesi për fituesin e kontratës.

4.3 Në paraqitjen e ofertës së vet në një tender, konkurrentët duhet të deklarojnë se nuk kanë asnjë konflikt të mundshëm interesi, dhe se nuk kanë asnjë lidhje specifike me konkurrentët e tjerë ose me palë të tjera që janë përfshirë për arsye të ndryshme në Projekt. Nëse një rrethanë e tillë do të shfaqej gjatë ekzekutimit të kontratës, fituesit e saj duhet të njoftojnë menjëherë institucionin prokurues.

4.4 Funkzionarë shtetërorë apo personel tjetër në administratën publike të vendit përfitues, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin ndodhen, nuk mund të angazhohen si ekspertë/konsulentë të shoqërive/sipërmarrjeve që marrin pjesë në tender pa pasur më parë një autorizim të MPJ/DPBZH-së.

4.5 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të veprojnë gjithnjë me paanshmëri dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk mund të bëjnë deklarata publike në lidhje me Projektin ose shërbimet që u kërkohen atyre, pa pasur më parë pëlqimin e institucionit prokurues. Ata (në çdo rast) nuk mund të angazhohen në asnjë mënyrë institucionin prokurues pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të tij.

4.6 Për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e saj, personeli i tyre dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të angazhohen të mos cenojnë parimet, traditat dhe zakonet politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti, fituesit e kontratave duhet të respektojnë standardet themelore të punës, siç përcaktohen në konventat kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO (si "Konventa mbi lirinë e sindikatës dhe mbrojtja e së drejtës së sindikatës", "Konventa për të drejtën e organizimit dhe negociimit kolektiv", "Konventa për punën e detyruar", "Konventa për diskriminimin (punësim dhe profesion)" dhe "Konventa për format më të këqija të punës së të miturve").

4.7 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm nuk mund të pranojnë pagesa që lidhen me kontratën, të ndryshme nga ato të parashikuara në vetë atë. Fituesit e kontratës, personeli i tyre dhe nënkontraktuesit nuk duhet të ushtrojnë asnjë veprimtari ose të marrin asnjë përfitim nga ana e institucionit prokurues që nuk do të përputhej me detyrimet përkatëse kontraktuale.

4.8 Përbën detyrim për fituesit e kontratës, personelin e tyre dhe nënkontraktues të mundshëm që të ruajnë sekretin profesional për gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuar ose të marrë nga fituesi i kontratës janë konfidencialë.

4.9 Kontrata duhet të rregullojë përdorimin, nga ana e gjithë kontraktuesve, e raporteve dhe e dokumenteve të hartuara, marrë ose paraqitur prej tyre gjatë zbatimit të kontratës.

4.10 Fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit e mundshëm duhet të shmangin çdo marrëdhënie/lidhje që do të vinte në rrezik/paragjykonte pavarësinë e tyre ose të personelit të tyre. Nëse fituesit e kontratës dhe nënkontraktuesit nuk do të ishin më të pavarur, autoriteti porosites, përveç dëshmëpërblimit të mundshëm të dëmeve që mund të jenë shkaktuar, mund të zgjidhë kontratën pa njoftim paraprak, dhe pa qenë e nevojshme që fituesi i kontratës të ngrejë pretendime për dëshmëpërblim.

4.11 MPJ/DPBZH-ja ruan të drejtën të ndërpresë dhe të anulojë financimin e Projektit, nëse praktika korrupsioni të çfarëdolloji do të shfaqeshin në çdo fazë të procedurës së shpalljes së fituesit, dhe nëse autoriteti porosites nuk do të ishte në gjendje të merrte të gjitha masat e duhura për zgjidhjen e rrethanës së shfaqur. Për efekte të kësaj klauzole, “praktika të korrupsionit” janë dhënie ryshfeti apo mitdhënia, dhurata, donacione ose komisione, të nënkuptuara si stimul ose shpërblim për çdo person që ka kryer ose nuk ka kryer qëllimisht çdo veprim në lidhje me prokurimin ose realizimin e një kontrate të lidhur me autoritetin porosites.

4.12 Më saktësisht, i gjithë dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përkatëse për punime, furnizime dhe shërbime, duhet të përmbajnë klauzolën që parashikon anulimin e tenderit ose zgjidhjen e kontratës nëse do të rezultonte se shpallja e fituesit ose ekzekutimi i kontratës do të kenë shkaktuar shpenzime tregtare jo të zakonit. “Shpenzime tregtare jo të zakonit” janë komisione a shpenzime të papërmendura në kontratën

kryesore, ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur rregullisht dhe që i referohet kontratës kryesore, komisione të papaguara pas shërbimeve të ligjshme dhe realisht të ofruara, komisione të paguara në një parajsë fiskale, komisione të paguara të një përfitues që nuk është qartësisht i identifikuar, ose komisione të paguara për një shoqëri që duket se kërkon të mbulojë një shoqëri tjetër.

4.13 Fituesit e kontratës, nëse do t’u kërkohet nga MPJ/DPBZH-ja, angazhohen të japin elemente provuese për të shpjeguar kushtet në të cilat zbatohet kontrata. MPJ/DPBZH-ja mund të kryejë çdo kontroll, dokumentacioni ose në vend, që do ta shihte të arsyeshëm për të mbledhur elemente prove në rast shpenzimesh tregtare të pazakonta të dyshimta.

4.14 Fituesit e kontratës që kanë paguar shpenzime tregtare të pazakonta në projekte të financuara nga MPJ/DPBZH-ja, në varësi të rëndësisë së fakteve të konstatuara, u nënshtrohen zgjidhjes së kontratës ose përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me financime të MPJ/DPBZH-së.

4.15 Mosrespektimi i një apo më shumë klauzolave etike nga ana e konkurrentit ose fituesit të kontratës dhe të nënsipërmarrësit, kur parashikohet nënsipërmarrja, mund të sjellë përjashtimin e tyre nga kontrata të tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, nga MPJ/DPBZH-ja, dhe aplikimi i penaliteteve. Individit ose shoqëria që do të konsiderohet përgjegjës/e duhet të informohet me shkrim për këtë fakt.

4.16 Përbën detyrim për autoritetin prokurues që procedurat e përftimit të mallrave dhe të shërbimeve të përcaktohen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe pavarësisht nga çdo ndikim i jashtëm.

**BASHKËLIDHJA 3**  
**PLANI FINANCIAR**

Nr.	Tender/tipologji	K. ndihme vlerësim euro	K. ndihme efektive	Mënyra e livrimit	Kontraktuesi	Shpenzime lokale %
A	<b>Njësia e menaxhimit të projektit</b>	<b>253.915,00</b>		15% paradhënie pas një kërkesë nga MFSH-ja, 50% pas miratimit dhe përfitimit të legjislacionit referues, evidenti-mit të angazhimit për të paktën 80% të transhit të parë, livrim efektiv i 40% të tij dhe kontroll më pas i një shoqërie auditimi. Pjesa e mbetur pas evidentimit të angazhimit të 80% të dy transheve të para, livrimit efektiv të 40% të tyre dhe raport pozitiv i shoqërisë së auditimit.	Institucioni zbatues është MBUMK-ja që do të krijojë një PMU për menaxhimin dhe koordinimin e Programit	MAX 75,00
	0.1	Ekspert italian	112.442,00			
	0.2	Personel teknik	48.000,00			
	0.3	Kosto administrimi dhe funksionimi	36.000,00			
	0.4	Të ndryshme (auditim, përkthime, interpretim, dieta, shërbime etj.)	57.473,00	Me livrim nga ana e Artigiancassa-s për subjekte fituese pas caktimit të çdo kontrate dhe shqyrtimit të faturave		
	<b>Fond shtetëror për kontribute mbi primet e sigurimit bujqësorë</b>		<b>1.300.000,00</b>			
	1.1	Fond kontributesh prime sigurimi	1.200.000,00			
	1.2	Pajisje me fond risigurimi	100.000,00			
<b>Nëntotali (A)</b>		<b>1.553.915,00</b>				
<b>Tender për furnizim shërbimesh dhe mallrash/Krijimi i tregut të sigurimeve bujqësore</b>		<b>446.085,00</b>				
2.1	Asistencë teknike dhe ligjore, përcaktim i kuadrit ligjor	44.385,00				
	Asistencë e					

2.2	specializuar për set up-in e sistemit të rilevimit të të dhënave meteorologjike	120.950,00			
2.3	Operatorë lokalë	17.000,00			
2.4	Asistencë teknike në menaxhimin e tregut të sigurimeve bujqësore në Shqipëri dhe në Itali	163.750,00 100.000,00			
2.5	Stacione meteorologjike				
<b>Nëntotali (B)</b>		<b>446.085,00</b>			
<b>TOTALI i Programit</b>		<b>2.000.000,00</b>			

**BASHKËLIDHJA 4**  
**MËNYRA TË EKZEKUTIMIT DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS**  
**SEKSIONI 0**  
**VEPRIMTARI PËRGATITORE DHE LIVRIMI I**  
**FONDEVE NË ADMINISTRIM TË MBUMK-së**

1. MBUMK-ja do të kujdeset të emërojë anëtarët e NJMP-së (2 persona) dhe do të vijojë më pas me përzgjedhjen e një eksperti italian, me përvojë dhe aftësi të provuara në sektorin e ndërhyrjes dhe me njohje të thelluar të vendit, në bazë të termave të referencës të përcaktuar bashkërisht (MBUMK/MPJ-DPBZH). Ky ekspert, i kontraktuar dhe shpërblyer nga MBUMK-ja nga fondet e kredisë së ndihmës, do të kujdeset të japë asistencë teknike për NJMP-në në kryerjen e detyrave të veta, për gjithë kohëzgjatjen e Programit (24 muaj).

2. MBUMK-ja, me mbështetjen e NJMP-së, do të përcjellë kërkesën për kreditim të transhit të parë të fondeve sipas sa përcaktohet në nenin 9 të Marrëveshjes.

**SEKSIONI I**  
**NISJA E VEPRIMTARIVE DHE MIRATIMI I**  
**PLANIT TË PROKURIMIT**

1. NJMP-ja, e asistuar nga eksperti italian siç tregohet në pikën 1, seksioni 0, përgatit propozimin për planin e prokurimit që do të përcillet nga MBUMK-ja në MPJ-DPBZH përmes Ambasadës;

2. Plani i prokurimit duhet të organizohet në bazë tenderash, duke përcaktuar shumat e disponueshme (në nivel vlerësimi) dhe tipologjinë e tenderave që duhet ndjekur (në bazë të procedurave të bashkëlidhjes 2). Kjo nënndarje duhet të mbajë parasysh mundësinë për të

kryer shpenzime në vend deri në një maksimum prej 75% të vlerës së kredisë;

3. NJMP-ja do të kryejë tendera të hapur për subjekte italiane publike dhe private. Në rast veprimtarish specifike të asistencës teknike institucionale, MBUMK-ja, kur të jetë e mundur, do ta prokurorë detyrën me prokurim të drejtpërdrejtë tek institucione publike italiane;

4. MPJ/DPBZH-ja do të shqyrtojë kështu planin e prokurimit nga pikëpamja teknike dhe ligjore dhe, në rast rezultati pozitiv, do ta miratojë, duke dhënë njoftim zyrtar për MBUMK-në nëpërmjet Ambasadës/NJTL.

**SEKSIONI II**  
**SHPALLJA E NJOFTIMIT PËR TENDER,**  
**PROCEDURA E ZBATIMIT**

NJMP-ja do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen e tenderave përkatës. Ky dokumentacion duhet përgatitur në përputhje me Manualin e Procedurave (PRAG i adoptuar nga Komisioni Evropian, versioni i fundit), përveç pjesës që ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën që do t'u përshtatet specifikave të kredisë së ndihmës italiane, si dhe nga sa saktësohet në bashkëlidhjen 2.

Në çdo rast, dokumentacioni:

- duhet të specifikojë “kushtet e posaçme” në lidhje me çdo tender;
- duhet të shtjellojë qartë kriteret e vlerësimit që do të përdoren nga komisioni i ngritur nga MBUMK-ja.

Metodologjia

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni për prokurimin e: i) shërbime të shërbimeve të asistencës teknike për hartimin e kuadrit ligjor referues; ii) shërbime asistence teknike dhe

trajnim për krijimin e tregut të sigurimeve bujqësore dhe iii) furnizime mallrash, do të përgatitet nga PMU-ja.

2. Verifikim i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i tenderit, pasi verifikohet dhe/ose plotësohet nga MBUMK-ja, do të dërgohet nga NJMP-ja pranë MBUMK-së në Ambasadë/NJTL, së bashku me kërkesën për shpallje të njoftimit për tender, për të verifikuar përputhshmërinë me këtë Marrëveshje. Ky verifikim do të bazohet veçanërisht në përputhjen e:

- procedurës së tenderit me planin e prokurimit të miratuar;

- përmbajtjes me karakter ligjor me procedurat e rreguluara në bashkëlidhjen 2;

- specifikave teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi synon të arrijë.

Ambasada/NJTL do t'i dërgojë MPJ/DPBZH-së dokumentacionin e tenderit për të verifikuar sa në kompetencë të saj.

3. Shpallja e njoftimit

Në rast se verifikimi do të dilte me sukses, njoftimi për tender do të botohet nga MPJ/DPBZH-ja në gazetata kryesore italiane dhe në faqen *web* të MPJ-së. MBUMK-ja do të vijojë njëkohësisht me shpalljen e njoftimit në gazetata kryesore kombëtare.

### SEKSIONI III

#### FAZA TË SHPALLJES SË FITUESIT - PROCEDURA E APLIKUAR

Zhvillimi i tenderit dhe verifikimi i përputhshmërisë së kriterëve të përdorura nga komisioni i vlerësimit:

- MBUMK-ja, përmes NJMP-së, do të ndjekë ecurinë e tenderit duke asistuar edhe komisionin e vlerësimit të ofertave (caktuar nga MBUMK-ja);

- pasi përfundon vlerësimi, përpara shpalljes zyrtare të fituesit, NJMP-ja do t'i kërkojë DPBZH-së të verifikojë përputhshmërinë e tenderit.

Metodologjia

1. Shqyrtimi i ofertave të sjella për çdo tender do të kryhet nga komisioni i vlerësimit i krijuar enkas nga MBUMK-ja. Në çeljen e ofertave dhe në çdo rast në gjithë mbledhjet e hapura të komisionit të vlerësimit, mund të marrë pjesë një përfaqësues i caktuar nga Ambasada/NJTL në cilësinë e vëzhguesit. NJMP-ja pranë MBUMK-së do të ndjekë ecurinë e tenderit duke asistuar – kur do të ishte e nevojshme - edhe komisionin.

2. Për çdo tender, MBUMK-ja, përmes NJMP-së, do t'i përcjellë Ambasadës/NJTL-së dokumentacionin që

përmban aktet e komisionit për vlerësimin e ofertave, së bashku me kontratën që do të lidhet dhe kërkesën për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratave. Ky dokumentacion do t'i përcillet MPJ/DPBZH-së nga Ambasada/NJTL së bashku me komentet e mundshme.

3. MPJ-DPBZH-ja do të verifikojë kryesisht përputhje ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera me procedura dhe kriteret/parametra në kreun e kushteve teknike të tenderit. Pasi të përfundojnë këto verifikime, MPJ-DPBZH-ja do të informojë Ambasadën/NJTL për rezultatin e tyre.

4. Në rast rezultati pozitiv (asnjë pengesë), MBUMK-ja, e asistuar nga NJMP-ja, do të vijojë me lidhjen e kontratës me institucionin italian që ka rezultuar fitues.

### SEKSIONI IV

#### FAZA TË MBËSHTETJES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMET - PROCEDURA E APLIKUAR

Kontratat që marrin formë zyrtare mes institucionit fitues dhe MBUMK-së duhet të mbërrin në MPJ/DPBZH përmes Ambasadës/NJTL-së, së bashku me një deklaratë angazhimi të Palës shqiptare për të përballuar kostot lokale (tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrime doganore etj.).

Metodologjia

1. Pasi merr dokumentacionin MPJ-DPBZH-ja do të kujdeset të lëshojë miratimin për autorizimin e MFQ-së, që do ta mbështesë kontratën në Marrëveshjen Financiare.

2. MFQ-ja do të përfundojë fazën përgatitore, duke i kërkuar institucionit fitues që mallrat dhe shërbimet të jenë me origjinë italiane dhe se shpenzimet që duhen përballuar në vend nuk mund të kalojnë vlerën e përcaktuar në çdo kontratë. Njëkohësisht, MFQ-ja do t'i kërkojë kredimarrësit shqiptar dërgimin e kërkesës për vënie në dispozicion të fondeve, duke e njoftuar kredimarrësin edhe për dhënien e miratimit nga ana e DPBZH-së.

3. Pasi merr të gjithë dokumentacionin e përmendur në pikën e mësipërme 2, MFQ-ja do të njoftojë kredimarrësin dhe PMU-në mbështetjen e kontratave në Marrëveshjen Financiare dhe mundësinë e financimit të tyre. Përfundimi i kësaj procedure do të bëjë të mundur livrimin e “paradhënies së pagesës”, të parashikuar në çdo kontratë, dhe do të përcaktojë datën e hyrjes në fuqi të saj.

4. Pagesat e tjera të mëvonshme mund të vendosen vetëm pas miratimit të NJMP-së për kryerjen e shërbimeve të parashikuara në çdo kontratë.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006